

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Raport Vjetor 2024



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

RAPORT VJETOR 2024

I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT
PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PËRMBAJTJA

FJALA HYRËSE E KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE	4
LISTA E SHKURTESAVE.....	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
Të arritura kryesore	6
Sfidat dhe pengesat	8
STRUKTURA E RAPORTIT.....	9
KAPITULLI 1: HYRJE	10
1.1 Roli dhe mandati i AKP-së.....	10
1.2 Fushëveprimi i AKP-së	10
1.3 Rregullat dhe procedurat e AKP-së.....	11
1.4 Misioni dhe visioni i AKP-së	11
KAPITULLI 2. BORDI I DREJTORËVE DHE MENAXHMENTI.....	12
2.1 Struktura e qeverisjes dhe roli i bordit të drejtorëve	12
2.2 Aktivitetet dhe mbledhjet e bordit të drejtorëve	12
2.3 Menaxhmenti ekzekutiv dhe roli i tij.....	13
2.4 Procesi i vendimarrjes në AKP.....	13
KAPITULLI 3: SHITJA E ASETEVE	15
3.1 Shitja e aseteve me tender publik	15
3.2 Shitja direkte e aseteve	16
3.3 Shitja e banesave të ndërmarrjeve shoqërore	16
3.4 Shpronësimi i aseteve të NSH-ve	17
3.5 Heqja dorë nga asetet	18
KAPITULLI 4: LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE	19
4.1 Përcaktimi i statusit të Ndërmarrjeve Shoqërore.....	19
4.2 Vendosja e NSH-ve/ aseteve në likuidim.....	19
4.3 Shqyrtimi i kërkesave të punëtorëve për 20% nga shitja dhe shpërndarja e mjeteve.....	20
4.4 Shqyrtimi i kërkesave kreditore dhe shpërndarja e mjeteve.....	20
4.5 Mbyllja e proceseve të likuidimit	22
KAPITULLI 5: MENAXHIMI I ASETEVE TË MBETURA TË NSH-VE.....	23
5.1 Plani i trajtimit të aseteve të mbetura	23
5.2 Asetet jashtë Kosovës.....	24
KAPITULLI 6: ADMINISTRIMI I NSH-VE DHE QIRADHËNIA E ASETEVE.....	25
6.1 Administrimi i NSH-ve	25
6.2 Qiradhënia e aseteve të NSH-ve.....	26
KAPITULLI 7: FONDET NË MIRËBESIM DHE BUXETI I AKP-SË.....	28
7.1 Të hyrat nga privatizimi dhe shpërndarja e fondeve në mirëbesim.....	28
7.2 Buxheti operativ i AKP-SË.....	29

KAPITULLI 8: FUNKSIONET E PËRGJITHSHME.....	30
8.1 Departamenti ligjor.....	30
8.2 Departamenti i administratës.....	30
8.3 Burimet njerëzore	31
8.4 Prokurimi.....	33
8.5 Zyra për media dhe marrëdhënie me publikun.....	33
8.6 Aktivitetet e marketingut.....	33
8.7 Auditimi i brendshëm.....	34
SHTOJCAT	35
STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	36

FJALA HYRËSE E KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

I nderuar Kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar përfaqësues të institucioneve dhe qytetarë,

Me përgjegjësi të lartë dhe përkushtim të plotë ndaj detyrës sonë, kam nderin t'ju paraqes **Raportin Vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit** për vitin 2024. Ky dokument përfaqëson një pasqyrë të plotë të punës dhe rezultateve të arritura nga Agjencia në përmbushjen e misionit të saj, si dhe sfidat me të cilat jemi përballur gjatë këtij viti.

Procesi i transformimit të pronës ka një rëndësi kyçe për zhvillim ekonomik të vendit, duke synuar jo vetëm transformimin e pronës shoqërore, por edhe rritjen e investimeve, dhe fuqizimin e sektorit privat dhe publik. Agjencia jonë ka punuar me përkushtim për të siguruar që çdo proces të zhvillohet në përputhje me parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe llogaridhënies.

Gjatë vitit të kaluar, kemi ndërmarrë një sërë iniciativash për të përsheptuar dhe optimizuar procesin e transformimit të pronës, duke përmirësuar procedurat administrative dhe duke rritur përgjegjshmërinë në menaxhimin e asetëve. Po ashtu, kemi zhvilluar mekanizma më efikas të monitorimit dhe vlerësimit, të cilët na kanë ndihmuar të identifikojmë sfidat dhe të marrim masa për përmirësim.

Gjatë vitit 2024 kemi vazhduar procesin e shitjes së asetëve dhe likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore. Njëkohësisht, kemi adresuar me përkushtim kërkesat e kreditorëve dhe të punëtorëve, duke trajtuar çështjet financiare dhe ligjore në përputhje me standardet më të larta profesionale. Një nga hapat e rëndësishëm ka qenë kategorizimi i asetëve duke vendosur bazat për një menaxhim më strategjik dhe të qëndrueshëm të tyre. Ndërsa, në bashkëpunim me institucionet e Republikës së Kosovës, kemi arritur që për herë të parë të vendosim nën administrim të AKP-së një numër asetesh të rëndësishme përfshirë asetet e Ndërmarrjes Shoqërore “Trepça Standard” në pjesën veriore të Kosovës.

Raporti vjetor përmban të dhëna të detajuara mbi aktivitetet e realizuara, rezultatet financiare dhe ndikimin që këto procese kanë pasur në transformimin e pronës shoqërore. Ai gjithashtu reflekton angazhimin tonë për të rritur standardet e qeverisjes korporative brenda Agjencisë.

Në këtë kontekst, dua të shpreh mirënjohjen time për të gjithë anëtarët e Bordit të Drejtorëve, ekipin menaxhues dhe stafin e Agjencisë për punën e palodhur dhe angazhimin e tyre të vazhdueshëm. Po ashtu, falënderoj Kuvendin dhe institucionet për mbështetjen dhe bashkëpunimin, të cilët janë thelbësorë për realizimin e suksesshëm të këtij procesi.

Duke ju lënë në dispozicion këtë raport për shqyrtim dhe diskutim, pres me interes vërejtjet dhe sugjerimet tuaja, të cilat do të na ndihmojnë në përmirësimin e mëtejshëm të punës sonë. Jemi të përkushtuar për të vazhduar me përpjekjet tona për një proces transparent të transformimit të pronës i cili do të jetë në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Faleminderit për vëmendjen tuaj!

Mentor Hyseni
Kryesues i Bordit të Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

LISTA E SHKURTESAVE

AKP.....	Agjencia Kosovare e Privatizimit
AKM.....	Agjencisë Kosovare e Mirëbesimit
ATK.....	Administrata Tatimore e Kosovës
AL.....	Autoriteti i Likuidimit
BiD.....	Bordi i Drejtorëve
BSPK.....	Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës
DhPGJS.....	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme
DE.....	Drejtori Ekzekutiv
FD.....	Fondi Sovran
KRK.....	Kuvendi i Republikës të Kosovës
QRK.....	Qeveria e Republikës së Kosovës
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
NSH.....	Ndërmarrje Shoqërore
OSH.....	Ofruesi i shërbimeve
OSHP.....	Ofruesi i shërbimeve profesionale (Autoriteti i Likuidimit)
SHAL.....	Shitja e Aseteve përmes Likuidimit
ZDE FP.....	Zëvendës Drejtor Ekzekutiv Funksione të Përgjithshme
ZDE O.....	Zëvendës Drejtor Ekzekutiv - Operativa
ZQ.....	Zyra Qendrore
ZR.....	Zyrat Regjionale

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Agjencia Kosovare e Privatizimit, gjatë vitit 2024 ka vazhduar me përkushtim realizimin e procesit të likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, shitjes së aseteve dhe përmirësimin e efikasitetit administrativ në përputhje me misionin dhe objektivat e saj. Ky raport përmbledh aktivitetet dhe arritjet kryesore të Agjencisë gjatë periudhës 01 janar - 31 dhjetor 2024, duke ofruar një pasqyrë të shkurtër dhe të përmbledhur mbi progresin e arritur, sfidat e hasura dhe përpjekjet për të zhvilluar proceset operacionale dhe për të rritur transparencën. Ky raport do të dorëzohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Të arritura kryesore

Të arriturat kryesore të AKP-së gjatë vitit 2024 lidhur me procesin e administrimit, shitjes dhe likuidimit të aseteve si dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve operative dhe administrative janë si më poshtë:

Shitja e Aseteve

- ◇ **Shitja e Aseteve me Tender:** AKP ka realizuar gjashtë 6 valë të shitjes së aseteve përmes procedurave të hapura të tenderimit. Nga 237 asete të tenderuara, 48 asete janë aprovuar, ndërsa 55 asete janë refuzuar. Të hyrat nga shitja me tender janë: 7,982,505 €;
- ◇ **Shitja Direkte e Aseteve:** Në disa raste të veçanta, AKP ka realizuar shitjen e aseteve me karakter specifik përmes procedurave të shitjes direkte. Si rezultat, janë aprovuar 10 raporte përfundimtare për shitje të aseteve dhe 185 raporte rekomanduese për fillimin e procedurave për shitje direkte. Të hyrat nga shitja direkte janë: 130,950 €;
- ◇ **Shitja e Banesave:** AKP ka shitur 22 banesa të personat me të drejtë banesore. Ndërsa 40 banesa janë refuzuar për shitje për shkak të mos plotësimit të kushteve dhe 5 banesa tjera janë refuzuar për jo kompetencë lëndore. Të hyrat nga shitja e banesave janë: 11,626 €;
- ◇ **Shpronësimi i Aseteve:** Qeveria e Kosovës ka shpronësuar asete të caktuara për nevoja të institucioneve publike. Të hyrat nga shpronësimi janë: 9,245,840 €;
- ◇ **Heqja Dorë nga Asetet:** AKP ka hequr dorë, pa kompensim, prej 115 aseteve, të cilat aktualisht shfrytëzohen për interes publik (p.sh. varreza, lapidare, rrugë publike, shtretër të lumenjve, etj).

Shpërndarja e Fondeve

- ◇ **Shpërndarja e Fondeve të Kreditorët:** Është aprovuar shpërndarja e mjeteve për 14,736 kërkesa kreditore në shumë prej: 5,734,745 €. Ndërsa janë shpërndarë: 4,746,620 €.
- ◇ **Shpërndarja e 20%-shit për punëtorët nga shitja:** Janë shpallur 36 lista fillestare dhe 4 lista finale me 5,052 punëtorë përfutues. Në emër të 20%-shit janë shpërndarë: 3,445,372 €.

Likuidimi i NSh-ve

- ◇ **Përcaktimi i statusit të NSh-ve:** Statusi është përcaktuar për 7 NSh, ndërsa për 6 ndërmarrje tjera përcaktimi i statusit është në proces.
- ◇ **Vendosja e NSh-ve në likuidim:** Janë vendosur 9 NSh të reja në likuidim. Në total janë 536 NSh në proces të likuidimit.

- ◇ **Mbyllja e procesit të likuidimit të NSh-ve:** Janë përmbyllur 13 NSh sipas aktvendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Administrimi i NSh-ve dhe Qiradhënia e Aseteve

- ◇ **Administrimi i NSh-ve:** Në proces të likuidimit janë 536 NSh, të cilat administrohen nga Autoriteti i Likuidimit. NSh që nuk janë në likuidim (5 NSh) janë nën administrim direkt. Katër (4) NSh kanë vazhduar të operojnë, të tjerat janë jo operative. Në këto NSh janë angazhuar 326 Ofrues të Shërbimeve.
- ◇ **Qiradhënia e asetëve:** Janë 1,222 kontrata të nënshkruara për dhënie të asetëve me qira. Prej tyre, 182 kontrata janë aprovuar gjatë vitit 2024. Të hyrat nga qiraja janë: 5,841,156 €.
- ◇ **Identifikimi i asetëve të reja:** Janë identifikuar dhe janë vënë nën administrim të AKP-së 13 asete të reja, asete këto që më herët nuk kanë qenë në regjistër të AKP-së.

Asetet e mbetura dhe trajtimi i tyre

- ◇ **Asete të mbetura:** Kanë mbetur 15,256 asete të NSh-ve. Prej tyre, 14,908 janë parcela apo me ndonjë objekt të ndërtuar. Shumica janë toka bujqësore. Ndërsa 348 asete tjera (objekte) janë prona të NSh-ve, mirëpo tokat ku ato ndodhen janë pronë e komunave apo të palëve tjera.
- ◇ **Transferimi i planifikuar i asetëve të mbetura:** 6,907 asete planifikohen të transferohen tek Fondi Sovran (pas themelimit); 3,121 asete (toka pyjore) planifikohen të transferohen tek Agjencioni i Pyjeve; 574 asete tek institucionet publike dhe prej 574 asetëve do të hiqet dorë për interes publik.
- ◇ **Shitja e planifikuar e asetëve të mbetura:** 3,033 asete do të shiten me tender publik, ndërsa 1,076 asete të natyrës specifike do të shiten përmes procedurave të shitjes direkte.

Organizimi dhe administrimi i AKP-së

- ◇ **Përfaqësimi Ligjor dhe Procedurat Gjyqësore:** Departamenti ligjor ka përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e AKP-së në 276 seanca gjyqësore në 263 konteste apo lëndë aktive në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Ndërsa, Dhoma e Posaçme ka nxjerrë 33 aktgjykime / aktvendime përfundimtare. Aktualisht janë 11,826 lëndë aktive në Kolegjet e Shkallës së Parë (Kolegjet e Specializuara) dhe 990 lëndë aktive me ankesë në Kolegjin e Apelit (Shkalla e Dytë dhe Përfundimtare e Dhomës së Posaçme).
- ◇ **Rekrutimi:** Bordi i Drejtoreve ka përzgjedhur zëvendës drejtorin ekzekutiv për operativë dhe zëvendës drejtorin ekzekutiv për funksione të përgjithshme. Drejtori ekzekutiv ka dhënë dorëheqje dhe këtë detyrë e ka ushtruar zëvendës drejtori për FP. Konkursi për rekrutim të drejtorit është shpallur dhe deri në datën e publikimit të këtij raporti nuk ka përfunduar.

| Sfidat dhe pengesat

Sfidat dhe pengesat kryesore që kanë ndikuar në procesin e administrimit, shitjes dhe likuidimit të aseteve si dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve operative dhe administrative të AKP-së janë si më poshtë:

- ◇ **Lëndët e pazgjidhura nëpër gjykata:** Janë mijëra lëndë në proces të shqyrtimit në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe në Gjykatat Themelore. Procesi i shitjes dhe likuidimit të NSh-ve varet nga vendimet e gjykatave. Kjo paraqet sfidë ngase gjykatat kanë kapacitete të limituara për shqyrtimin e lëndëve dhe shqyrtimi i disa lëndëve mund të zgjasë me vite.
- ◇ **Vonesa në qasjen e dokumenteve kadastrale:** Vonesat e Komunave në dhënien e informacioneve ndikon në realizimin e planit për shitje të aseteve.
- ◇ **Pagesa e pronave të shpronësuara nga ana e Qeverisë:** Janë 1,499 asete të shpronësuara deri më tani. Vlera e shpronësimeve për të cilat ende nuk ka marrëveshje të zotimit me institucionet relevante është 81,076,943 € . Vonesat në realizimin e tyre ndikojnë në likuidimin e NSh-ve si dhe në implementimin e strategjisë përmbyllëse të AKP-së.
- ◇ **Mungesë e ofertave të blerësve:** Ka asete që nuk marrin asnjë ofertë ngase nuk janë atraktive për tërheqjen e blerësve. Kjo ndikon në ri-tenderimin e tyre.
- ◇ **Mungesë e dokumentacionit në përcaktimit të statusit të NSh-ve:** Statusi i disa ndërmarrjeve nuk mund të përcaktohet për shkak të mungesës së dokumentacionit të nevojshëm. Kjo ndikon në procesin e shitjes së aseteve dhe në likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore.
- ◇ **Komasacioni:** Është ndër sfidat me të mëdha të Agjencisë. Është mbajtur takimi me Ministrinë e Bujqësisë dhe Agjencinë Kadastrale, mirëpo deri me tani nuk ka zhvillime konkrete.
- ◇ **Ekonomitë Pyjore dhe të Gjuetisë:** Sipas Ligjit për Pyjet nr. 08/L-137, asetet pyjore (toka, pyje, kullosa) i takojnë Agjencisë së Pyjeve. Mirëpo, dorëzimi i tyre nuk është bërë ende për shkak të mosgatishmërisë së Agjencisë për t'i pranuar.
- ◇ **Themelimi i Fondit Sovran:** Një numër i konsiderueshëm i aseteve planifikohet të bartet në Fondin Sovran. Ligji për FS është aprovuar në vitin 2023. Mirëpo, Fondi nuk është themeluar ende për arsye se Ligji është dërguar në Gjykatë Kushtetuese dhe ende pritet vendimi final.
- ◇ **Trajtimi i aseteve me probleme:** Shumë asete në portfolion e AKP-së kanë probleme të natyrave specifike, si: probleme juridiko - pronësore, probleme kadastrale, nevojë për parcelim, etj. Zgjidhja e këtyre problemeve është parakusht për shitje apo bartje të aseteve.
- ◇ **Bartja e pronave me vendime të Gjykatave:** Disa prona të NSh-ve kanë kaluar në pronësi të personave privat apo të komunave sipas vendimeve të gjykatave të Kosovës.

STRUKTURA E RAPORTIT

Raporti është i ndarë në 8 kapituj, që ofrojnë një pasqyrë mbi aktivitetet dhe rezultatet e AKP-së:

Kapitulli 1.....Hyrje

Kapitulli 2.....Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti Ekzekutiv

Kapitulli 3.....Shitja e Aseteve

Kapitulli 4.....Likuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore

Kapitulli 5.....Menaxhimi i Aseteve të mbetura të Ndërmarrjeve Shoqërore

Kapitulli 6.....Administrimi i Ndërmarrjeve Shoqërore dhe Qiradhënia e Aseteve

Kapitulli 7.....Fondet në Mirëbesim dhe Buxhetit i AKP-së

Kapitulli 8.....Funksionet e Përgjithshme

KAPITULLI 1: HYRJE

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), si institucion përgjegjës për menaxhimin dhe zbatimin e procesit të privatizimit dhe likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSh) ka luajtur një rol kyç në përmirësimin e efikasitetit të pronës shtetërore. Ky raport përmbledh aktivitetet, arritjet dhe sfidat gjatë vitit 2024, duke reflektuar angazhimin e institucionit për një proces transparent, të drejtë dhe të suksesshëm të privatizimit dhe likuidimit. Ky raport synon të:

- ◇ Paraqesë një pasqyrë të detajuar mbi progresin e arritur në procesin e shitjes dhe likuidimit.
- ◇ Evidentojë sfidat e hasura gjatë implementimit të procesit të privatizimit dhe likuidimit.
- ◇ Përcaktojë drejtimet strategjike për vitin e ardhshëm.

1.1 Roli dhe mandati i AKP-së

AKP është organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht autonome. AKP ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me Ligjin nr. 04/L-034, si dhe të padisë e të paditet në emër të saj. AKP është themeluar nga Kuvendi i Republikës të Kosovës në korrik 2008 si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) që është themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”, dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë asete dhe përgjegjësi të Agjencisë. AKP i raporton Kuvendit të Kosovës në baza vjetore.

1.2 Fushëveprimi i AKP-së

NSh-të që janë nën administrim të AKP-së, kanë funksionuar në sektorë të ndryshëm, përfshirë përpunimin e metalit, plastikës, letrës, hotelieri, miniera, agro-industri, bujqësi, pylltari, material ndërtimor, ndërtimtari, tekstil, verari dhe vreshtari, prodhimin e birrës, duhanit, shitjen me shumicë dhe pakicë. Shumica e pronës industriale e Kosovës, tokat bujqësore, pronat komerciale janë prona të NSh-ve. Administrimi, privatizimi apo likuidimi adekuat dhe me kohë i tyre është me rëndësi jetike dhe i kontribuon drejtpërdrejt rindërtimit dhe zhvillimit ekonomik të Kosovës si dhe mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve të saj. Aktualisht, nën administrimin e AKP-së janë 548 NSh, statusi i të cilave është si më poshtë:

NDËRMARRJET SHOQËRORE NËN ADMINISTRIM TË AKP-SË

Përshkrimi	Numri
Numri total i ndërmarrjeve shoqërore të administruara nga AKP ndër vite	607
Numri i ndërmarrjeve të përmbyllura deri më tani me vendim të Dhomës së Posaçme	(59)
Numri aktual i Ndërmarrjeve Shoqërore nën administrim të AKP-së	548
Numri i ndërmarrjeve shoqërore që janë në proces të likuidimit	536
Numri i ndërmarrjeve shoqërore që akoma nuk janë vendosur në likuidim	12

| 1.3 Rregullat dhe procedurat e AKP-së

AKP operon në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullat në fuqi, duke siguruar një proces të drejtë dhe konkurrues për shitjen dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe aseteve shoqërore. Ligji bazik i AKP-së është Ligji nr. 04/l-0341 për AKP, i ndryshuar¹. Ndërsa aktet kryesore nënligjore të AKP-së janë:

1. Rregullorja nr. 01/2024 për procedurat e Divizionit të listave të 20%-shit të punëtorëve;
2. Rregullorja nr. 02/2024 për qiradhëniet e aseteve të NSh-ve;
3. Rregullorja nr.04/2024 për shitjen direkte të aseteve të caktuara të NSh-ve– 30 shtator 2024;
4. Rregullorja nr.03/2024 për angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve në likuidimin e NSh-ve;
5. Metodologjia-Shtojca e Procedurave të Shitjes;
6. Procedurat e shitjes me tender publik.

Këto akte janë plotësuar në vitin 2024 me qëllim të rritjes së transparencës dhe efikasitetit të proceseve.

| 1.4 Misioni dhe visioni i AKP-së

Misioni i AKP – Agjencia është e autorizuar për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e ndërmarrjeve dhe aseteve të NSh-ve. Për realizimin e këtij misioni, AKP mban dhe administron secilën ndërmarrje (nën mandatin e saj) në mirëbesim dhe në të mirë të pronarëve dhe kreditorëve të tyre, si dhe shet ose likuidon ndërmarrjet dhe asetet në përputhje me ligjin.

Vizioni i AKP - Agjencia është e vendosur për të trajtuar me shpejtësi ndikimet pozitive për ekonominë si dhe nxitjen e investimeve në Ndërmarrjet Shoqërore, përmes autorizimeve të gjera publike administrative që i ka mbi këto ndërmarrje dhe asete, duke përfshirë, por pa u kufizuar, mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose aseteve tek investitorët privat, ose likuidimin e tyre përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa të panevojshme, në përputhje me Ligjin e AKP-së, aktet nënligjore të AKP-së dhe legjislacionin në fuqi.

¹ Ligji nr. 04/l-0341 për AKP, është ndryshuar / plotësuar me ligjin nr. 04/l-115, ligjin nr. 05/l-080 dhe ligjin nr. 06/l-023.

KAPITULLI 2. BORDI I DREJTORËVE DHE MENAXHMENTI

Ky kapitull e përshkruan përbërjen, rolin dhe procesin e vendimmarrjes së Bordit të Drejtorëve dhe të Menaxhmentit Ekzekutiv të AKP-së.

2.1 Struktura e qeverisjes dhe roli i bordit të drejtorëve

Bordi i Drejtorëve (BiD) është organi më i lartë i AKP-së dhe ka kompetenca të plota për Agjencinë. BiD ka një strukturë të veçantë, me funksione mbikëqyrëse dhe ekzekutive. Përveç përgjegjësive për përcaktimin e strategjive dhe politikave të privatizimit, Bordi ka gjithashtu fuqinë për të marrë vendime ekzekutive për menaxhimin operativ dhe implementimin e këtyre politikave. Kjo strukturë e ndihmon agjencinë të veprojë me shpejtësi dhe fleksibilitet dhe të marrë vendime në një mjedis dinamik dhe të ndryshueshëm privatizimi.

Bordi i Drejtorëve përbëhet nga 8 anëtarë duke përfshirë një anëtarë të komunitetit jo-shumicë dhe një përfaqësues nga sindikatat e punëtorëve, të cilët janë emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Bordi është emëruar me datë 6 gusht 2021. Mandati i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve është 4 vjeçar.

Divizioni i Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve

Divizioni i Sekretarisë së Bordit ofron shërbime ligjore këshilluese, administrative dhe teknike dhe koordinon këto shërbime në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe në funksion të mbarëvajtjes së procesit të vendimmarrjes së Bordit të Drejtorëve.

Gjatë vitit 2024, Divizioni i Sekretarisë së Bordit ka luajtur një rol kyç në mbështetjen e funksionimit të rregullt dhe efektiv të Bordit të Drejtorëve të AKP-së. Në kuadër të përgjegjësive të saj, Sekretaria ka siguruar organizimin e mbledhjeve, përgatitjen e dokumentacionit, mbajtjen e procesverbaleve, dhënien e këshillave dhe monitorimin e zbatimit të vendimeve të Bordit. Po ashtu, ka marrë pjesë në disa grupe punuese dhe komisione të themeluara nga Bordi.

2.2 Aktivitetet dhe mbledhjet e bordit të drejtorëve

Bordi i AKP-së takohet në baza të rregullta mujore. Gjatë vitit 2024, Bordi ka mbajtur **22 mbledhje**, ku janë diskutuar dhe janë marrë 1,081 vendime formale dhe udhëzime për menaxhmentin ekzekutiv për çështje të ndryshme strategjike dhe operacionale.

Vendimet Kryesore të Bordit:

- ♦ Janë shpallur 6 valë të shitjes, 48 asete janë aprovuar për shitje, 55 asete janë refuzuar;
- ♦ Janë aprovuar 436 raporte rekomanduese dhe 10 raporte përfundimtare për shitje direkte;
- ♦ Janë aprovuar 69 kërkesa për shitje të banesave (aprovime, refuzime);
- ♦ Janë transferuar 10 asete të shpronësuara të institucionet publike të Republikës së Kosovës;
- ♦ Është larguar ndërmarrja “Kosova Film” nga kompetencat dhe administrimi i AKP-së;
- ♦ Është aprovuar heqja dorë nga 115 asete për interes publik;
- ♦ Është aprovuar qiradhënia për 231 asete me tender dhe qiradhënia direkte për 84 asete;

- ◇ Është aprovuar statusi i NSh-ve për 7 ndërmarrje të reja;
- ◇ Është aprovuar fillimi i likuidimit për 9 NSh;
- ◇ Janë aprovuar shpërndarjet për kreditorët e 20 NSh-ve në likuidim;
- ◇ Janë aprovuar 25 lista përfundimtare të punëtorëve të 20%-shit dhe shpërndarjet e mjeteve;
- ◇ Është aprovuar rritja e buxhetit për finalizimin e procedurave të likuidimit për 10 NSh;
- ◇ Janë aprovuar 6 raporte përfundimtare për përmbyllje të NSh-ve në likuidim;
- ◇ Është vazhduar mandati i BiD dhe Drejtorit Menaxhues të NSh "Inex Sharr Planina Brezovicë";
- ◇ Është aprovuar plani i punës, buxheti dhe raportet tjera obligative për vitin 2025.

Me datë 27 qershor 2024, Bordi ka emëruar Zëvendës Drejtor Ekzekutiv Operativë z. Burim Leci, ndërsa me datë 16 gusht 2024 ka emëruar Zëvendës Drejtor Ekzekutiv Funksione të Përgjithshme z. Ibrahim Gjylderren. Bordi po ashtu ka aprovuar dorëheqjen e Drejtorit Ekzekutiv, z. Arben Limani me datë 16 shtator 2024 dhe në këtë pozitë ka emëruar U.D. z. Ibrahim Gjylderren. Muajt në vijim është shpallur konkursi për DE dhe ka dështuar, sepse një nga dy kandidatët në listë të ngushtë është tërhequr nga konkursi. Konkursi do të vazhdojë sipas procedurave pas afatit të ankesave.

Përveç kësaj, komiteti i Auditimit, i përbërë prej një drejtori të Bordit, dhe dy anëtarëve të jashtëm ka mbajtur 6 takime. Gjithashtu, komisioni i vlerësimit të performancës së menaxhmentit, i përbërë prej tre drejtorëve të Bordit, ka mbajtur 15 takime.

2.3 Menaxhmenti ekzekutiv dhe roli i tij

Menaxhmenti ekzekutiv i AKP-së, ndërsa ka përgjegjësi për administrimin e aktiviteteve të përditshme, ka një rol mbështetës në implementimin e vendimeve ekzekutive të Bordit. Pavarësisht se Bordi ka fuqi ekzekutive, menaxhmenti ekzekutiv mbetet i angazhuar në koordinimin dhe monitorimin e proceseve operative. Gjatë periudhës raportuese, aktivitetet e përgjithshme të Agjencisë janë menaxhuar nga Drejtori Ekzekutiv, Zëvendës Drejtori Ekzekutiv - Operativa dhe Zëvendës Drejtori Ekzekutiv - Funksione të Përgjithshme. Sipas organogramit të ri të aprovuar në tetor 2023, AKP i ka pesë (5) departamente² dhe gjashtë (6) divizione të veçanta³.

2.4 Procesi i vendimarrjes në AKP

Vendimarrja në AKP është një proces i strukturuar dhe i kontrolluar, i cili siguron që çdo hap të jetë në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret përkatëse. Procesi i vendimarrjes përfshin këto hapa:

Propozimi i Vendimeve: Në fillim, divizionet e caktuara të AKP-së identifikojnë nevojat dhe mundësitë për privatizim, likuidim apo shitje të aseteve, si dhe shqyrtojnë situatën aktuale të aseteve. Pastaj, përgatisin propozime dhe raporte që paraqesin opsionet e mundshme për shitje.

² i) Departamenti i Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve; ii) Departamenti i Koordinimit Rajonal dhe Operativës; iii) Departamenti i Ligjor; iv) Departamenti i Financave dhe Buxhetit; dhe v) Departamenti i Administratës.

³ i) Divizioni i Burimeve Njerëzore; ii) Divizioni i Prokurimit; iii) Divizioni i Shitjeve Direkte; iv) Divizioni i Auditimit të Brendshëm; v) Divizioni i Kontrollës dhe Administrimit Direkt dhe vi) Divizioni i Sekretarisë Ekzekutive të Bordit.

Diskutimi dhe Rishikimi nga Bordi i Drejtorëve: Pas përgatitjes së propozimeve, menaxhmenti ekzekutiv i paraqet për shqyrtim dhe miratim në Bord. Bordi shqyrton propozimet dhe diskuton alternativat e mundshme. Bordi mund të kërkojë informacion shtesë dhe mund të sugjerojë ndryshime ose përmirësime në propozim.

Miratimi i Vendimeve: Pas shqyrtimit dhe diskutimeve, Bordi miraton vendimin përfundimtar. Ky vendim mund të jetë një vendim miratimi për procesin e privatizimit ose likuidimit të një NSh, për shitjen e një aseti, për shpalljen e ofertave, për qiradhënie ose për procedura të tjera të menaxhimit të aseteve.

Zbatimi i Vendimeve: Pas miratimit të vendimeve, Menaxhmenti Ekzekutiv është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Bordit. Ky proces mund të përfshijë përgatitjen e tenderëve, kontratave dhe negociatave me investitorët. Menaxhmenti është përgjegjës për monitorimin e implementimit dhe siguron që të gjitha procedurat të ndodhin sipas ligjit dhe rregulloreve të përcaktuara.

Mbikëqyrja dhe Vlerësimi i Përformancës: Bordi gjithashtu mbikëqyrë procesin e implementimit dhe vlerëson rezultatet e shitjeve. Bordi mund të bëjë vlerësime periodike të përformancës dhe të kërkojë raporte mbi rezultatet e privatizimit dhe efektet afatgjata.

Përmes këtij procesi, AKP ka arritur të realizojë privatizime dhe likuidime të suksesshme, duke siguruar që pasuritë shtetërore të menaxhohen në mënyrë efikase dhe transparente.

KAPITULLI 3: SHITJA E ASETEVE

Metoda e zakonshme që përdor AKP për shitjen e aseteve në procesin e likuidimit është shitja me tender publik. Në raste të veçanta dhe të arsyetuara ligjërish, asetet shiten edhe përmes shitjeve direkte. Banesat në pronësi të NSh-ve u shiten shfrytëzueseve legjitim sipas kushteve dhe çmimit të përcaktuar me Ligjin për Banesa. Përveç shitjeve të lartpërmendura, një numër i aseteve tjera shpronësohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK) dhe institucionet publike për interes të përgjithshëm, duke paguar kompensimin për shpronësim. Ndërsa një numër më i vogël i aseteve, përjashtohet nga procesi i shitjes për shkak se shfrytëzohen për interes publik. AKP heqë dorë nga këto asete dhe pronësia mbi to bartet të komunat përkatëse pa kompensim. Gjatë vitit 2024, përmes këtyre proceseve janë transformuar 209 asete në total, dhe janë realizuar të hyra në vlerë prej 17,370,921 €.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i aseteve të shitura dhe të hyrat nga shitja në vitin 2024:

TRANSFORMIMI I ASETEVE (JANAR - DHJETOR 2024)

Përshkrimi	Nr. i aseteve të transformuara	Të hyrat nga shitja e aseteve €
Shitja e aseteve me tender publik	49 ⁴	7,982,505
Shitja direkte e aseteve	7	130,950
Shitja e banesave të NSh-ve	35	11,626
Shpronësimi i aseteve	3	9,245,840
Heqja dorë nga asetet	115 ⁵	N/A
Gjithsej:	209	17,370,921

3.1 Shitja e aseteve me tender publik

Procesi i shitjes së aseteve me tender realizohet përmes valëve të shitjes me likuidim, ku asetet individuale u ofrohen blerësve potencial përmes tenderëve të hapur dhe konkurrues. Procesi i shitjes së aseteve përfshinë: i) shpalljen e listës së aseteve për shitje, ii) dorëzimin e ofertave, iii) hapjen e ofertave, iv) aprovimin e shitjeve, dhe v) nënshkrimin e kontratave.

Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar 6 valë të Shitjeve së Aseteve përmes Likuidimit (SHAL) me tender publik ku janë tenderuar gjithsej 237 asete. Për 129 asete ka pasur oferta, ndërsa për 108 asete tjera nuk është pranuar asnjë ofertë. Si rezultat, 48 asete janë aprovuar për shitje, ndërsa për 55 asete ofertat janë refuzuar për shkak të çmimeve të ulëta të ofruara. Ndërsa për 25 asete në SHAL 70, ofertat janë pranuar në dhjetor 2024, ndërsa vendimmarrja është shtyrë për fillim të vitit 2025.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat për shitjen e aseteve me tender publik gjatë vitit 2024:

SHITJA E ASETEVE ME TENDER (JANAR - DHJETOR 2024)

Përshkrimi	SHAL65	SHAL66	SHAL67	SHAL68	SHAL69	SHAL70	Gjithsej
Asete të tenderuara	26	47	35	47	55	27	237
Asete pa oferta	11	19	20	25	31	2	108
Asete me oferta	15	28	15	22	24 ⁶	25 ⁷	129
Asete të aprovuara	9	16	8	5	10	-	48
Asete të refuzuara	6	12	7	17	13	-	55
Kontrata të përmbyllura	9	16	5	3	2	-	49 ⁸
Total të hyrat €							7,982,505 €⁹

⁴ Për qëllime të raportimit ky numër paraqet numrin e kontratave të përmbyllura gjatë vitit 2024.

⁵ Numri 115 paraqet asetet për heqje dorë të dorëzuara në BiD dhe në DhPGJSK për aprovim me gjithsej 77 raporte.

⁶ Një (1) aset SHAL69: Njësia nr.43 Gazela Prishtinë – pezullim vendimmarrje - masë e përkohshme nga OVGJSK.

⁷ Vendimmarrja për 25 asete që kanë pranuar oferta në SHAL 70 është shtyrë për mbledhjen e BD të muajit janar 2025.

⁸ Gjatë procesit të shitjes së aseteve me tender publik në vitin 2024, përveç SHAL-ave të listuara në tabelë, ka pasur përmbyllje të kontratave në SHAL 58; SHAL63; SHAL64.

⁹ Nga 7,982,505 € të mbledhura gjatë vitit 2024, 1,710 828 € janë për asetet e shitura në 2023 (SHAL 58, 63 dhe 64).

3.2 Shitja direkte e aseteve

Sipas ligjit të AKP-së dhe rregullores së brendshme për shitje direkte të aseteve, asetet me karakter specifik¹⁰ shiten përmes procedurave të shitjes direkte. Shitja direkte e aseteve inicohet me kërkesë të palëve të interesuara. Nëse aset i kërkuar hynë në kategorinë e aseteve specifike, BiD e aprovon fillimin e procesit të shitjes direkte. Pas arritjes së marrëveshjes me palën për kushtet dhe çmimin e shitjes, BiD aprovon realizimin e shitjes. Ndërsa pas kryerjes së pagesës, nënshkruhet kontrata dhe prona bartet tek blerësi.

Gjatë vitit 2024, janë paraqitur 287 kërkesa të reja për blerje direkte të aseteve, duke rritur numrin total të kërkesave të pranuar në 2,842. Ndërsa BiD ka aprovuar 185 raporte rekomanduese për fillimin e procedurave për shitje direkte dhe 10 raporte përfundimtare për shitjen e aseteve.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur aktivitetet kryesore të procesit të shitjes direkte të aseteve:

SHITJA DIREKTE E ASETEVE		
Përshkrimi	Viti 2024	Tërë procesi – deri 31 dhjetor 2024
Numri i kërkesave të pranuar për shitje direkte	287	2,842
Numri i kërkesave të shqyrtuara për shitje direkte	436	1,086
Numri i raporteve rekomanduese të miratuara në BiD	185	646
Numri i raporteve përfundimtare të miratuara në BiD	10	379
Numri i kërkesave të refuzuara në BiD	251	440
Numri i kontratave të nënshkruara	7	360
Të hyrat e realizuara nga shitjet direkte / €	130,950 €	10,639,810 €

3.3 Shitja e banesave të ndërmarrjeve shoqërore

Disa NSh kanë banesa në pronësi të tyre, të cilat në të kaluarën u janë ndarë punonjësve të NSh-ve për të jetuar. Shitja e banesave të tilla për të cilat ekziston e drejta banesore bëhet sipas Ligjit Nr.04/L-061 për Shitjen e Banesave.

Këto banesa kanë të drejtë t'i blejnë personat që: i) kanë pasur kontratën e të drejtës banesore para vitit 1999; ii) që kanë pasur vendimin e NSh-së për ndarjen e banesës në shfrytëzim; dhe iii) kanë vazhduar të banojnë në banesë. Këto banesa mund t'i blejnë edhe trashëgimtarët e personit me të drejtën banesore.

Procesi i shitjes së banesave inicohet me kërkesë të palëve të interesuara. Kërkesat shqyrtohen nga Komisioni i Banesave i AKP-së, ndërsa aprovoohen apo refuzohen nga BiD.

Gjatë vitit 2024, janë shqyrtuar 67 kërkesa në total. Prej tyre, 22 janë aprovuar për shitje, 40 janë refuzuar si të pabazuara, dhe 5 janë refuzuar për shkak të jo kompetencës lëndore të AKP-së. Ndërsa, kanë mbetur pa u shqyrtuar 132 kërkesa, të cilat do të trajtohen gjatë vitit vijues.

¹⁰ **Asetet specifike** - aset me karakter specifik perkufizohen ato asete ose pjesë të aseteve të cilat sipas gjendjes faktike, bazës ligjore te pretendimit, vetive ose karakteristikave tjera, përbëjnë çështje me natyrë specifike ose komplekse, me ç'rast si pasojë e rrethanave të tilla të drejtat pronësore mbi këto asete nuk mund të barten tek palët e treta në mënyrë ekskluzive përmes rregullave të tenderimit publik ose parashihet se tenderimi publik krijon efekte negative në procesin e transformimit pronësor të një asemi konkret.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur informatat rreth shitjes së banesave të NSH-ve:

SHITJA E BANESAVE		
Përshkrimi	2024	Tërë procesi
Numri total i kërkesave të pranuar në AKP	104	1,945 ¹¹
Numri i kërkesave të shqyrtuara në BiD	67	1,701
Numri i kërkesave të aprovuara nga BiD	22	928
Numri i kërkesave të refuzuara nga BiD	40	389
Numri i kërkesave të refuzuara për shkak se AKP nuk është kompetente	5	384
Numri i kontratave të nënshkruara për shitjen e Banesave	35	908 ¹²
Numri i kërkesave të pa shqyrtuara	0	132

3.4 Shpronësimi i aseteve të NSH-ve

Shpronësimi është një proces ligjor, ku Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK), apo institucioni publik merr një aset të NSH-së për interes publik, duke paguar kompensim. Vendimin për shpronësim e merr QRK. Ndërsa AKP ndihmon në menaxhimin e procesit dhe zgjidhjen e çështjeve ligjore.

Procesi i shpronësimit kalon nëpër disa faza. Së pari, institucioni përkatës propozon shpronësimin për një projekt publik. QRK e merr vendimin preliminar për shpronësim, ndërsa Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) e shqyrton statusin e pronës, përgatitë elaboratin e shpronësimit dhe bënë vlerësimin e pronës. Pastaj, QRK merr vendimin përfundimtar të shpronësimit, ku caktohet edhe procedura e kompensimit.

Sa i përket kompensimit, QRK fillimisht paguan 20% të vlerës së pronës së shpronësuar. Në rast se NSH-ja të cilës i takon aseti i shpronësuar nuk ka fonde të mjaftueshme për të paguar të gjithë kreditorët e saj të ligjshëm, atëherë QRK i paguan ata kreditorë, por jo me shumë se pjesa e papaguar prej 80% të vlerës së pronës.

Gjatë vitit 2024, QRK ka marrë 3 vendime përfundimtare të shpronësimit të aseteve të NSH-ve. Ndërsa të hyrat e pranuar të shpronësimit ishin 9,245,840 €.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur përmbledhja e rezultateve të shpronësimit:

SHPRONËSIMI I ASETEVE		
Përshkrimi	2024	2010-2024
Numri i vendimeve preliminare të Qeverisë për shpronësim	3	667
Numri i vendimeve përfundimtare të Qeverisë për shpronësim	3	183
Vlera e aseteve të shpronësuara sipas vendimeve përfundimtare	9,492,696.20	107,927,644.00
Shuma e paguar nga Qeveria për asetet e shpronësuara	9,245,840	28,266,183.10
Shuma e mbetur për pagesë nga Qeveria për asetet e shpronësuara / €	N/A	83,628,355.00

Gjatë periudhës 2010 – 2024, QRK ka marrë 850 vendime të shpronësimit me shumë totale prej 107,927,644.00 €. Prej tyre, deri më tani janë paguar 28,266,183.10 €. Vlera e kërkesave për shpronësim ndër vite për të cilat ende nuk ka marrëveshje të zotimit për pagesë me institucionet përkatëse është në

¹¹ Nga gjithsej 1,945 kërkesa të pranuar, Komisioni i Banesave ka konstatuar se vetëm 1,701 kërkesa kanë plotësuar kushtet për trajtim të mëtutjeshëm.

¹² Nga 928 kërkesa të aprovuara, janë nënshkruar 908 kontrata, për arsye se për 20 kërkesa të aprovuara nuk janë bërë pagesat ende.

vlerën prej 83,628,355.00 €. Këto procese të pa përfunduara të shpronësimit kanë ndikim në përmbylljen e likuidimit të NSh-ve si dhe në implementimin e strategjisë përmbyllëse të AKP-së.

3.5 Heqja dorë nga asetet

Disa asete apo pjesë të aseteve përjashtohen nga procesi i shitjes për shkak se shfrytëzohen për interes publik (p.sh. varreza, lapidare, rrugë publike, shtretër të lumenjve etj). AKP heqë dorë nga këto asete dhe pronësia mbi to bartet tek komunat përkatëse pa kompensim. Vendimin për heqje dorë nga asetet e merr BiD sipas propozimit të paraqitur nga Autoriteti i Likuidimit. Ndërsa vendimin përfundimtar për heqje dorë nga asetet e merr Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK). Gjatë vitit 2024, AKP ka hequr dorë prej 115 aseteve.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur përmbledhja e aktiviteteve në lidhje me procesin e heqjes dorë nga asetet e NSh-ve gjatë vitit 2024:

HEQJE DORË NGA ASETET		
Përshkrimi	janar-dhjetor 2024	Tërë procesi
Numri total i aseteve për heqje dorë	115	220
Numri i raporteve të dorëzuara në BiD për aprovim	77 ¹³	164
Numri i raporteve të aprovuara / refuzuara nga BiD	0	0
Numri i raporteve të aprovuara / refuzuara nga DhPGjSK	0	0
Numri i raporteve në pritje të aktvendimit nga DhPGjSK	77	164
Numri i aseteve të mbetura për heqje dorë	347	347

Sfidat kryesore të procesit të heqjes dorë prej aseteve janë: i) mungesa e informatave / aktvendimeve nga DhPGjSK; ii) mungesa e të dhënave kadastrale; iii) vendimet e autoriteteve publike të vendit ku ndodhen asetet; iv) çështjet që kanë të bëjnë me uzurpimin e këtyre aseteve; si dhe v) vështirësitë në qasjen në objektet e aseteve që ndodhen jashtë vendit.

¹³ Numri 77 paraqet raportet për heqje dorë të aseteve të dorëzuara në BiD dhe në DhPGjSK për aprovim me gjithsej 115 asete/ngastra.

KAPITULLI 4: LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE

Likuidimi i ndërmarrjeve shoqërore i referohet procesit të mbylljes së ndërmarrjeve shoqërore të paqëndrueshme dhe transformimin e aseteve të tyre për të optimizuar përdorimin e resurseve dhe për të stimuluar zhvillimin ekonomik. Ky proces kalon nëpër disa faza. Pas përcaktimit të statusit të një NSh-je, me vendim të BiD, NSh vendoset në likuidim dhe i caktohet Autoriteti i Likuidimit (AL), i cili e udhëheq procesin e likuidimit. Funksionin e AL-së e ushtron Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (OSHP) i angazhuar përmes procedurave të prokurimit¹⁴. Nëse NSh-të nuk kanë asete dhe/ose kërkesa kreditore, procesin e likuidimit të tyre e udhëheq divizioni i likuidimit i AKP-së. Sidoqoftë, pas vendosjes së NSh-së në likuidim, fillon shitja e aseteve të saj, dhe trajtohen kërkesat e punëtorëve të 20%-shit dhe të kreditorëve. Pas shitjes së aseteve, shpërndahen mjetet për punëtorët (20%) dhe për kreditorët. Në fund, me vendim përfundimtar të Dhomës së Posaçme përfundon procesi i likuidimit dhe shuhet ndërmarrja.

Në këtë kapitull janë paraqitur informatat për aktivitetet e kryera të AKP-së dhe rezultat e arritura në procesin e likuidimit të NSh-ve, përfshirë: përcaktimin e statusit të NSh-ve; vendosjen e NSh-ve në likuidim; shpërndarjen e fondeve të punëtorët (në emër të 20%-shit) dhe të kreditorët; si dhe mbylljen e procesit të likuidimit të NSh-ve.

4.1 Përcaktimi i statusit të Ndërmarrjeve Shoqërore

Si parakusht për vendosjen e një ndërmarrje në likuidim, duhet të vlerësohet nëse ajo ndërmarrje është ndërmarrje shoqërore dhe bie nën mandatin e AKP-së, apo ka status tjetër juridik dhe është jashtë mandatatit të AKP-së¹⁵. Statusin e NSh-ve e shqyrton dhe e rekomandon komisioni i posaçëm i AKP-së, ndërsa vendimin e merr BiD. Gjatë vitit 2024, me rekomandim të komisionit, BiD ka aprovuar statusin për 7 NSh.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur përmbledhja e aktiviteteve në lidhje me procesin e përcaktimit të statusit (SDR) të NSh-ve gjatë vitit 2024:

STATUSI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE	
Statusi i NSh-ve	Viti 2024
Numri i NSh-ve me status të aprovuar nga BiD	7
Numri i ndërmarrjeve në pritje të shqyrtimit të statusit nga BiD	11

4.2 Vendosja e NSh-ve/ aseteve në likuidim

Pas përcaktimit të statusit të një NSh-je, me vendim të BiD ndërmarrja / aset vendoset në likuidim, shpallet fillimi i procesit të likuidimit dhe caktohet AL për ta udhëhequr procesin e likuidimit. Nëse NSh-ja nuk ka asete dhe / ose nuk ka kërkesa kreditore, procesi i likuidimit udhëhiqet nga divizioni i likuidimit i AKP-së. Gjatë vitit 2024, janë vendosur 9 NSh të reja në likuidim. Aktualisht janë 536 NSh në proces të likuidimit.

¹⁴ Gjatë vitit 2024, funksionin e AL-së e ka ushtruar konzorciumi i përbërë prej tri kompanive ndërkombëtare konsulente Curtis Mallet-Prevost, Colt & Mosle LLP, Grant Thornton Consulting Doo dhe Grant Thornton LLC.

¹⁵ Statusin e NSh-ve e shqyrton dhe rekomandon komisioni i AKP-së, ndërsa vendimin e merr BiD.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i NSh-ve të likuiduara dhe ato që janë në proces të likuidimit.

LIKUIDIMI I NSh-ve			
Përshkrimi	Numri i NShve	Të vendosura në likuidim	Të likuiduara
Likuidimi nga Autoriteti i Likuidimit	541	513	28
Likuidimi nga divizioni i likuidimit i AKP	54	23	31
Numri i NSh-ve në likuidim	595	536	59
NSh ende të pavendosura në likuidim	12	-	-
Gjithsej NSh nën administrim të AKP-së	607	536	59

4.3 Shqyrtimi i kërkesave të punëtorëve për 20% nga shitja dhe shpërndarja e mjeteve

Procesi i listave të punëtorëve të NSh-ve si përfitues të 20%-it nga transformimet pronësore është i rregulluar me rregulloret e UNMIK-ut 2003/13 dhe 2004/45 si dhe aktet nënligjore të Agjencisë.

Lista fillestare e punëtorëve të NSh-ve hartohet nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK). Këto lista shqyrtohen nga AKP, e cila i bën ndryshimet e nevojshme dhe të njëjtat i publikon si lista fillestare. Punëtorët e pakënaqur me listat e publikuara kanë të drejtë ankese në afat prej 20 ditësh në AKP. Pas shqyrtimit të ankesave, formohet lista përfundimtare e punëtorëve të kualifikuar, e cila miratohet nga BiD i AKP-së së bashku me shpërndarjen e parakohshme të 20%-it për punëtorët e kualifikuar. Pas publikimit të listës përfundimtare, palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në afat prej 20 ditësh nga dita e fundit e publikimit të listës përfundimtare pranë Dhomës së Posaçme. Pas vendimit final të Dhomës së Posaçme bëhet shpërndarja e pjesshme e fondeve të 20%-shit të punëtorët përfitues, pjesa tjetër shpërndahet kur Dhoma e Posaçme vendos për numrin e ankesave dhe kundërshtime me vendim final. Gjatë vitit 2024, janë shpërndarë 3,445,372 € për 5,052 punëtorë përfitues të 20%-shit nga shitja e aseteve.

Në tabelë janë paraqitur informatat lidhur me procesimin e listave të punëtorëve të NSh-ve për 20%.

LISTAT E PUNËTORËVE TË NSh-VE PËR 20%		
Përshkrimi	Janar- dhjetor 2024	Tërë procesi
Shuma e shpërndarjeve të 20%-it për punëtorët e NSh-ve	3,445,372 €	166,902,483 €
Numri i listave finale të punëtorëve	23	393
Numri i punëtorëve për të cilët janë bërë pagesat	5,052	52,187
Numri vendimeve të formës së prerë nga Dhoma e Posaçme	2	303
Numri i listave finale në pritje për shqyrtim nga gjykata	23	113

4.4 Shqyrtimi i kërkesave kreditore dhe shpërndarja e mjeteve

Pas vendosjes së një NSh-je në likuidim, kreditorët kanë të drejtë të paraqesin kërkesat për borxhet e pretenduara ndaj tyre. AL i shqyrton kërkesat dhe harton një listë të përkohshme të kreditorëve, ku shënohen pretendimet e pranuar dhe të refuzuara. Kreditorët mund të paraqesin ankese ndaj vendimeve të AL-së.

Pas shqyrtimit të ankesave hartohen listat përfundimtare kundër të cilave kreditorët mund të parashtrijnë ankesa në Dhomën e Posaçme. Pas vendimit përfundimtar të Dhomës së Posaçme bëhet shpërndarja përfundimtare e fondeve tek kreditorët¹⁶.

Kreditorët paguhen sipas prioritetit të përcaktuar me ligj¹⁷. Pas pagesave, procesi i likuidimit mbyllet me raport përfundimtar, i cili dorëzohet në Dhomën e Posaçme për aprovim. Nëse fondet nuk mjaftojnë për të mbuluar të gjitha borxhet, kreditorët mund të mbeten me humbje të pjesshme ose të plotë.

Gjatë vitit 2024, është aprovuar pagesa për 14,736 kërkesa kreditore në shumë prej 5,734,745 €, ndërsa janë shpërndarë mjetet në shumë prej 4,384,648 €.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shumat e shpërndara ndaj kreditorëve të NSh-ve gjatë tri viteve në fundit dhe në total¹⁸.

PAGESA E KREDITORËVE TË NSh-ve				
Përshkrimi	Viti 2024 (€)	Viti 2023 (€)	Viti 2022 (€)	2011- 2024 (€)
Pagat e punëtorëve	2,654,378	735,798	3,443,770	25,980,666
ATK	168,058	700,239	1,450,865	10,377,282
Trustet pensionale	142,374	104,932	277,722	4,616,394
Tatimi në pronë	54,860	318,586	718,051	3,168,047
Komunalitë	35,808	221,490	948,825	4,099,390
Kreditorë të tjerë	1,691,142	1,749,683	8,231,752	18,114,954
Gjithsej	4,746,620 €	3,830,728 €	15,070,985 €	66,356,733 €

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shumat e aprovuara dhe të shpërndara ndaj kreditorëve të NSh-ve gjatë periudhës 2010 – 2024

PAGESAT E APROVUARA KUNDREJT PAGESAVE TË SHPËRNDARA NDAJ KREDITORËVE			
Viti	Shuma (në €)	Pagesa (në €)	Diferenca (në €)
2010-2019	30,526,889	30,384,175	142,714
2020	5,766,047	5,664,502	101,545
2021	8,410,295	8,257,670	152,625
2022	15,077,430	14,760,825	316,605
2023	2,941,587	2,904,913	36,674
2024	5,743,745	4,384,648	1,359,097
Për korrigjim v.2024	(24,665)	-	(24,665)
Gjithsej	68,441,328 €	66,356,733 €	2,084,595 €¹⁹

Trajtimi i kërkesave kreditore dhe shpërndarja e mjeteve²⁰ varet nga faktorë të jashtëm. Pengesat kryesore që ndikojnë në numrin e raporteve të aprovuara të kreditorëve janë: i) mos-realizimi i shitjeve sipas planit apo kalendarit të shitjes; ii) vonesat eventuale të Dhomës së Posaçme në zgjidhjen e

¹⁶ Mund të bëhet shpërndarja e pjesshme e mjeteve ndaj kreditorëve para vendimit të Dhomës së Posaçme nëse dihet numri dhe vlera e pretenduar e ankesave dhe mjetet janë rezervuar për vlerën e ankesave.

¹⁷ Trajtimi i kërkesave kreditore me prioritet: i) shpenzimet e likuidimit, ii) punëtorët (paga të papaguara dhe benefite), iii) kreditorët e siguruar (ata që kanë kolateral), dhe iv) kreditorët e tjerë të zakonshëm.

¹⁸ Raportimi i shënimeve në tabelë është bërë për periudhën deri me 31 dhjetor 2024, pasi që OSHP-ja raporton në bazë mujore.

¹⁹ Shuma e papaguar prej 2,084,595 përfshinë periudhën nga viti 2019 deri 31 dhjetor 2024.

²⁰ Raporte të përkohshme, raporte të përkohshme të pjesshme, raporte përfundimtare dhe raporte përfundimtare të pjesshme të shpërndarjes.

ankesave të kreditorëve; iii) mungesa e informatave nga Dhoma e Posaçme për numrin dhe vlerën e ankesave të kreditorëve; dhe iv) mos-realizimi i pagesave nga ana e QRK-së për asetet e shpronësuara.

4.5 Mbyllja e proceseve të likuidimit

Mbyllja e procesit të likuidimit të NSh-ve bëhet me aktvendim të Dhomës së Posaçme sipas raportit përfundimtar të aprovuar nga BiD i AKP-së. Një NSh mbyllet pas shitjes së të gjitha aseteve të saj, shlyerjes së kërkesave të punëtorëve dhe kreditorëve dhe shpërndarjes së fondeve, vendimit për shuarjen, si dhe çregjistrimit të ndërmarrjes nga lista e ndërmarrjeve.

Deri në fund të vitit 2024, sipas aktvendimeve të Dhomës së Posaçme janë mbyllur gjithsej 59 NSh. Aktualisht në DhPGjSK janë në shqyrtim raportet përfundimtare për përmbylljen e 6 NSh-ve tjera.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i NSh-ve të mbyllura dhe numri i NSh-ve në pritje të vendimit të Dhomës së Posaçme për mbylljen e tyre.

NUMRI I NSH-VE TË MBYLLURA & NË PROCES TË MBYLLJËS

Aktivitetet	Viti 2024	Tërë procesi
Numri i NSh-ve të mbyllura me aktvendim nga DhPGjSK	13	59
Numri i NSh-ve në proces të mbylljes nga DhPGjSK	6	6

Sfidat kryesore të procesit të mbylljes së NSh-ve janë: i) kontestet pronësore dhe ligjore; ii) ankesat e kreditorëve; iii) proceset e gjata gjyqësore të Dhomës së Posaçme; iv) mos-realizimi i shitjes së aseteve; v) lëndët/paditë për vërtetim të pronësisë të deleguara nga DhPGjSK në Gjykatat Themelore; dhe vi) identifikimi i aseteve të NSh-ve të deklaruara si pa asete.

KAPITULLI 5: MENAXHIMI I ASETEVE TË MBETURA TË NSH-VE

Ky kapitull jep një pasqyrë të detajuar mbi asetet e NSh-ve që ende nuk janë privatizuar, duke përfshirë analizën e gjendjes aktuale dhe planet për menaxhimin dhe transformimin e tyre.

5.1 Plani i trajtimit të aseteve të mbetura

Në fund të vitit 2024, asetet e mbetura²¹ (të pa shitura) të NSh-ve me të cilat ende administron AKP-ja janë gjithsej 15,256. Prej tyre 14,908 janë parcela me objekte apo vetëm **parcela** dhe 348 janë vetëm objekte pa tokë. Veç tyre, janë edhe 191 asete tjera jashtë Kosovës. Sipas planit strategjik të AKP-së, asetet e mbetura të NSh-ve do të transformohen si më poshtë:

- ◇ **6,907 parcela dhe objekte** planifikohen të barten tek Fondi Sovran (FS). Aktualisht FS nuk është themeluar ende për arsye se ligji për FS (i aprovuar në 2023) është dërguar në Gjykatë Kushtetuese për shqyrtim dhe pritet të merret vendimi final. Si opsion, këto asete mund të barten të ndonjë institucion tjetër për t'u menaxhuar deri në themelimin e FS-së.
- ◇ **3,121 parcela** (toka, pyje, kullosa) do të barten tek Agjencia Pyjore. Sipas Ligjit për Pyjet nr. 08/L-137 i vitit 2023, pronësia mbi pyjet dhe tokat pyjore ka kaluar tek Agjencia Pyjore brenda Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Ndërsa, dorëzim – pranimi i aseteve nuk ka ndodhur ende për shkak të mosgatishmërisë së Agjencisë së Pyjeve për pranimin e tyre.
- ◇ **574 parcela** do të kalojnë tek institucionet e ndryshme për interes publik. Kjo do të realizohet përmes procedurave të shpronësimit sipas vendimeve të QRK-së.
- ◇ **545 parcela** do të jenë subjekt i heqjes dorë në interes publik ngase se ato aktualisht përdoren si pasuri të përbashkëta publike dhe si të tilla nuk mund t'i nënshtrohen procesit të shitjes.
- ◇ **2,697 parcela dhe 336 objekte** do të shiten përmes procedurave të tenderimit publik.
- ◇ **1,076 parcela** do të trajtohen përmes shitjes direkte. Këto janë parcelat për të cilat palët e interesuara kanë parashtruar kërkesa për shitje direkte. Mirëpo, nëse kërkesat refuzohen si të pabazuara, asetet do të shiten përmes procedurave të tenderimit.

Sidoqoftë, numri total i aseteve si dhe kategorizimi i tyre mund të ndryshoj në periudhat pasuese, varësisht nga ndërrimi i statusit të NSh-ve apo identifikimi e aseteve të reja të NSh-ve përkatëse.

²¹ Për dallim nga viti 2023 ku asetet e mbetura janë paraqitur në bazë të grupimeve për shitje, raporti i vitit 2024 i referohet kategorizimit të ngastrave të cilat më gjerësisht janë të paraqitura në tabelën e radhës.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i aseteve të mbetura dhe trajtimi i tyre.

RI-KATEGORIZIMI I PARCELAVE / NGASTRAVE

Përshkrimi	Numri i parcelave me / pa objekte	Numri i objekteve pa parcela ²²	Total parcela dhe objekte	Në %
Asetet për Fond Sovran	6,895	12	6,907	45.27 %
Asetet për Agjencinë Pyjore	3,121	0	3,121	20.46%
Asetet interes Publik	574	0	574	3.76 %
Asetet për heqje dorë	545	0	545	3.57 %
Asete për shitje me tender	2,697	336	3,033	19.88%
Asete për shitje direkte	1,076	0	1,076	7.05 %
Gjithsej	14,908	348	15,256	100 %

Sfidat kryesore të procesit të administrimit të aseteve të mbetura dhe transformimit të tyre janë: i) masat e përkohshme nga DhPGJSK; ii) masat e përkohshme nga Gjykatat tjera/kërkesat për masë të përkohshme pa vendim të DhPGJSK; iii) komasacioni; iv) mungesa e dokumentacionit të pronësisë si dhe të dhënat e vjetruara kadastrale të pronësisë në raste kur NSh-ja posedon të dhëna të gabuara sa i përket pronësisë të aseteve të caktuara; v) zyrat Komunale Kadastrale në shumë raste nuk janë shumë bashkëpunuese dhe vazhdimisht refuzojnë të azhurnojnë të dhënat kadastrale; vi) pagesa e pronave të shpronësuar nga ana e QRK-së; vii) parcelimet, mospërputhjet e gjendjes grafike me tekstuale, mungesa e ndarjeve grafike etj.

5.2 Asetet jashtë Kosovës

Përveç aseteve të paraqitura më lartë, janë edhe 191 asete të NSh-ve të ndryshme që ndodhen në vendet e rajonit, Këtu përfshihen edhe 22 asete të Ndërmarrjes Trepça. Deri në vitin 2024, AKP ka pas vështirësi të ndryshme për shitjen e tyre. Në mungesë të të dhënave të mjaftueshme për këto asete, ka qenë e pamundur të realizohet shitja e tyre përmes procedurave të përcaktuara me ligjin e AKP-së. Ekziston rreziku i bartjes së këtyre në pronësi të palëve të treta sipas vendimeve të gjykatave të vendeve ku ndodhen ato asete. Sidoqoftë, pas përpjekjeve të shumta, AKP ka arritur që në vitin 2024 të zhvilloj për herë të parë procesin e shitjes me tender publik për disa asete në Mal të Zi (Podgoricë). Si rezultat, 1 aset është shitur, ndërsa ofertat për 3 asete janë refuzuar për shkak të çmimit të ulët.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i aseteve jashtë Kosovës.

ASETET E PASHITURA JASHTË KOSOVËS

Shteti	Numri i Aseteve
Bosna dhe Hercegovina	20
Kroaci	8
Mali i Zi	40
Maqedoni	7
Serbi	115
Slloveni	1
Gjithsej	191²³

²² Asetet tjera përfshijnë asete të ndryshme të kategorisë të pronave rezidenciale dhe komerciale përrshirë, si: lokale, objekte, depo, pompa të benzinës, etj.

²³ Brenda totalit të aseteve jashtë Kosovës janë edhe 22 asete të ndërmarrjes Trepça dhe atë: 3 asete në Bosne dhe Hercegovinë, 3 në Kroaci, 5 në Mal të Zi, dhe 11 në Serbi.

KAPITULLI 6: ADMINISTRIMI I NSH-VE DHE QIRADHËNIA E ASETEVE

Ndërmarrjet shoqërore administrohen nga AKP deri në përmbylljen e procesit të likuidimit të tyre. Ndërsa asetet e NSh-ve, deri sa të shiten apo barten tek institucionet tjera, jepen me qira. Ky kapitull jep një pasqyrë të detajuar për administrimin e NSh-ve dhe qiradhënien e aseteve.

6.1 Administrimi i NSh-ve

Prej momentit të vendosjes së NSh-ve në likuidim deri në përmbylljen e tyre, ato administrohen prej autoritetit të likuidimit. Aktualisht, janë 536 NSh në likuidim. Prej tyre, 533 NSh nuk operojnë fare. Vetëm 3 NSh kanë vazhduar të operojnë edhe pas futjes në likuidim, nën mbikëqyrjen e AL-së: NSh Grand Hotel, NSh Tregu dhe NSh Genci. Ndërsa nga gjithsej 5 ndërmarrjet nën administrim direkt, vetëm NSh Inex Sharr Planina Brezovicë operon me aktivitetin e vet primar.

Shumica e NSh-ve kanë asete të ndryshme, të cilat administrohen prej AKP-së (AL-së dhe administratorit). Gjithashtu, në një numër të NSh-ve janë angazhuar 326 ofrues të shërbimeve, kryesisht për sigurimin fizik të objekteve dhe për ofrimin e shërbimeve tjera, sidomos në NSh-të operative.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i NSh-ve operative dhe jo operative si dhe numri i ofrueseve të shërbimeve.

NSH OPERATIVE, JO OPERATIVE & NUMRI I OFRUESËVE TË SHËRBIMEVE			
NSH	Në administrim të AL-së	Në administrim direkt	Ofrues të shërbimeve
NSh me aktivitet operativ	3	1	131
NSh pa aktivitet operativ	533	4	195 ²⁴
Gjithsej	536	5	326

NSh Grand Hotel Prishtinë

Hoteli Grand është shitur nga AKM (tani AKP) në Valën 8 të privatizimit përmes metodës së Spin-off-it Special, që është mbajtur në tetor 2006. Blerësi, përveç çmimit prej 8 milionë e 160 mijë euro, kishte për obligim që të investonte 20 milionë e 200 mijë euro gjatë periudhës së monitorimit dhe të punësonte 570 punëtorë. AKP ka angazhuar dy procese auditimi të jashtme për të vërtetuar realizimin e zotimeve nga ana e blerësit dhe nga dy auditimet e realizuara është konstatuar se nuk janë përmbushur zotimet e parapara me marrëveshjen e zotimeve. Për shkak të shkeljes së kushteve kontraktuale, në maj 2012 AKP ka vendosur për tërheqjen e aksioneve në ndërmarrjen e re “Grand Hotel” dhe kthimin nën administrimin e AKP-së. Të gjitha procedurat gjyqësore lidhur me tërheqjen e aksioneve kanë përfunduar me vendime gjyqësore përfundimtare nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe nga Gjykata Kushtetuese në favor të AKP-së.

Ndërmarrja Hoteli Grand është nën administrimin e AKP-së, ndërsa që nga data 2 shkurt 2015, me vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së është vendosur në proces të likuidimit. AKP do të koordinohet me Qeverinë e Republikës së Kosovës për transformimin e këtij aseti, përmes privatizimit apo në ndonjë formë tjetër.

²⁴ Brenda totalit të aseteve jashtë Kosovës janë edhe 22 asete të ndërmarrjes Trepca dhe atë: 3 asete në Bosne dhe Hercegovinë, 3 në Kroaci, 5 në Mal të Zi, dhe 11 në Serbi.

NSh Inex Sharr Planina Brezovicë

Në dhjetor 2020, me vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, NSh Inex Sharr Planina Brezovicë është futur në Administrim Direkt të AKP-së.

Në ndërmarrje janë të angazhuar 90 punëtorë, kurse gjatë sezonit turistik angazhohen rreth 50 punëtorë sezonal, të cilët punojnë në Qendrën e Skijimit në Brezovicë në pozita të ndryshme. Të hyrat kryesore ndërmarrja i realizon nga aktiviteti primar i ndërmarrjes gjatë sezonit dimëror nga qendra e skijimit në Brezovicë, por edhe nga lëshimi i aseteve me qira, si dhe nga lëshimi i sallës së Hotelit Narcis për mbajtje të dasmave dhe ahengjeve gjatë sezonit të verës. Gjatë vitit 2024 kanë qenë të lëshuara me qira 15 asete, ku janë inkasuar qiratë në vlerë prej 70,890.39 €, si dhe inkasimet nga aktivitetet operative të ndërmarrjes kanë qenë 721,826. €21.

Gjatë vitit 2024, Ndërmarrja ka pasur nevojë për huazim të mjeteve financiare, prandaj i janë huazuar mjetet nga tarifa administrative për t'i mbuluar shpenzimet e pagave të punëtorëve dhe kryerjen e investimeve kapitale të domosdoshme për funksionimin e qendrës së skijimit. Vlera e mjeteve të transferuara nga tarifa administrative gjatë vitit 2024 ka qenë 40,832.00 €, të cilat mjete do të kthehen kur ndërmarrja të krijoj të hyra vetanake që mbulojnë shpenzimet operative. Me qëllim të përgatitjeve për sezonin dimëror 2024/2025, në dhjetor të vitit 2024 është implementuar sistemi i ri për pagesën elektronike për ski pass, ku përfshihet zhvillimi i programit për kategorizimin e ski pass, blerja e 1,500 kartelave (ski pass) me siguri të lartë, blerja e printerëve fiskal dhe lidhja e tyre me sistemin e ATK-së, si dhe janë instaluar POS nga NLB Bank për pagesa përmes kartelës bankare.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të hyrat dhe shpenzimet e NSh Inex Sharr Planina Brezovicë gjatë vitit 2024.

TË HYRAVE DHE SHPENZIMET GJATË VITIT 2024 PËR NSH BREZOVIKA

Pranimet operative	Pranimet nga qiratë	Huazimi nga AKP	Gjithsej Pranimet	Gjithsej Shpenzimet
721,826.21 €	70,890.39 €	40,832.00 €	792,716.60 €	804,760.16 €

| 6.2 Qiradhënia e aseteve të NSH-ve

NSH-të në administrim të AKP-së kanë asete të shumta me probleme pronësore apo kadastrale që e pamundësojnë shitjen e tyre. Deri në zgjidhjen e problemeve dhe shitjen e tyre, një numër i konsiderueshëm i këtyre aseteve jepen me qira për t'ia ruajtur dhe / ose rritur vlerën. Zakonisht, asetet jepen me qira përmes procedurave të tenderimit publik. Në raste të veçanta asetet mund të jepen me qira me procedura direkte. Kontratat e qirasë janë një vjeçare me mundësi të vazhdimit dhe të shkëputjes së parakohshme.

Qiramarrësi nuk e fiton të drejtën e blerjes së asetit me përparësi, as nuk konsiderohet i kualifikuar për blerjen direkte të asetit. Në fund të vitit 2024, numri total i aseteve të dhëna me qira ishte 1,222. Prej tyre, 1,145 asete janë të NSH-ve në likuidim, (587 asete janë të NSH Tregu). Ndërsa 77 asete tjera të dhëna me qira janë të NSH-ve në administrim direkt.

Gjatë vitit 2024, janë bërë 5 shpallje publike për qiradhënien e 908 aseteve, ndërsa BiD ka aprovuar për qiradhënie 121 asete, përfshirë 7 asete të NSH-ve në administrim direkt. Shumica e ofertave janë

refuzuar për shkak të çmimit të ulët të ofruar. Duhet të theksohet se gjatë vitit 2024 janë dërguar në përmbnim 26 raste të qiramarrëseve që kanë qenë pagues të parregullt për periudhën paraprake të borxheve me vlerë të përgjithshme prej: 181,623 €.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i aseteve të dhëna me qira dhe të hyrat nga qiraja.

HYRAT E PËRGJITHSHME NGA QIRADHËNIA E ASETEVE GJATË VITIT 2024

Përshkrimi	Numri i aseteve me qira	Inkasimi i qirave €
Asetet e NSh-ve në likuidim	1,145	5,109,018 €
Asetet e NSh-ve në AD	77	732,137 €
Gjithsej	1,222	5,841,156 €

KAPITULLI 7: FONDET NË MIRËBESIM DHE BUXETI I AKP-SË

Në këtë kapitull janë paraqitur të hyrat nga procesi i privatizimit dhe shpërndarja e fondeve si dhe shpenzimet operative të AKP-së për vitin 2024.

7.1 Të hyrat nga privatizimi dhe shpërndarja e fondeve në mirëbesim

Fondet në mirëbesim janë fonde të mbajtura nga AKP për llogari të kreditorëve të NSh-ve ose për palë të tjera të interesuara derisa të bëhet shpërndarja e tyre sipas ligjeve në fuqi. Këto fonde krijohen nga: i) të hyrat nga shitja e aseteve gjatë procesit të privatizimit dhe likuidimit; ii) të hyrat nga qiradhënia e aseteve të menaxhuara përkohësisht nga AKP. Këto fonde në mirëbesim, mbahen për përmbushjen e detyrimeve financiare dhe ligjore sipas Ligjit nr. 04/L-034 për AKP që janë kryesisht për shpërndarjen e 20%-it të punëtorëve nga shitja e aseteve, pagesat ndaj kreditorëve, për tarifën administrative të AKP-së dhe çështje të tjera të tilla si mallra dhe shërbime gjatë procesit të administrimit apo likuidimit të NSh-ve. AKP i menaxhon këto fonde në emër të NSh-ve në llogari të veçanta bankare në Bankën Qendrore të Kosovës dhe janë të ndara nga buxheti operativ i AKP-së. Gjatë vitit 2024, të hyrat janë 23.9 mil €, pagesat janë 11.1 mil €, ndërsa bilanci i mbetur vjetor 12.7 mil €. Për krahasim janë edhe të dhënat për vitin 2023. Ndërsa, gjendja në fondet e mirëbesimit nga tërë procesi i privatizimit dhe likuidimit prej vitit 2003 deri në fund të vitit 2024 është: 928.7 mil €, pagesat 749.5 mil €, bilanci i mbetur prej 178.1 mil €.

Detajet janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

PRANIMET DHE PAGESAT GJATË VITIT 2024

PRANIMET	2023 Hyrje (€)	2024 Hyrje (€)	% 2024 vs 2023 (%)	2003 -2024 Hyrje (€)
Të hyrat nga shitja e aseteve	5,408,810	17,370,921	221.1%	806,504,191
Të hyrat nga qiraja	5,310,881	5,519,944	3.9%	68,301,928
Interesi i fituar	312,448	517,127	65.5%	35,674,275
Të hyrat nga tarifa & konfiskimet e depozitave në tenderët e shitjes	36,200	159,500	340.6%	9,188,165
Bid depozitat për Pjesëmarrje në Tender	(89,500)	208,500	(332.9)%	330,000
Të hyra tjera	(235,440)	181,427	(177.0)%	7,728,755
Kapitali themeltar i AKP-së	-	-	0.00%	1,013,200
Gjithsej pranimet	10,743,399	23,957,419	123%	928,740,514
PAGESAT / SHPËRNDARJET	2023 Dalje (€)	2024 Dalje (€)	% 2024 vs 2023 (%)	2003 -2024 Dalje (€)
20% i punëtorëve transferuar në BSPK	3,229,677	3,445,372	6.6%	166,902,483
Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoritetet e Likuidimit)	499,800	499,800	0.0%	18,405,857
Mallra dhe shërbime	1,660,991	1,792,552	7.9%	27,613,269
Shpenzimet komunale	178,674	105,587	(40.9)%	3,546,080
Tatimet	764,646	750,624	(1.8)%	13,492,192
Vendimet e gjykatave/përmblyesve (depozita dhe taksa)	47,226	89,028	88.5%	8,626,864
Transferi i mjeteve 5% për mbulimin e aktiviteteve të AKP-së	-	-	0.0%	45,777,947
Të tjera	12,393	7,098	(42.7)%	891,272
Pagesat ndaj kreditorëve të NSh-ve	3,830,728	4,746,620	23.9%	66,356,733
Fondet transferuar Buxhetit të Kosovës	-	(248,794)	(100.0)%	397,984,947
Gjithsej pagesat	10,224,135	11,187,887	9.43%	749,597,644
BILANCI I PRANIMEVE DHE PAGESAVE	519,264	12,769,532	2,359%	179,142,870

Në fund të vitit 2024, obligimet e papaguara nga palët e treta ndaj AKP-së (llogaritë e arkëtueshme) ishin në shumë prej 57.2 mil €, ndërsa obligimet e papaguara nga AKP ndaj palëve të treta (llogaritë e pagueshme) ishin 2.1 mil €.

LLOGARITË E ARKËTUESHME DHE TË PAGUESHME TË FONDEVE NË MIRËBESIM

Llogaritë e arkëtueshme	Viti 2024 (€)	Viti 2023 (€)
Ndëshkimet me Spin-Off Speciale	29,318,296	29,318,296
Nga shitja e aseteve	8,171,724	9,357,628
Nga shpronësimi i aseteve të NSH-ve	4,095,000	4,023,099
Të hyra nga qiraja	15,617,250	15,725,837
Gjithsej	57,202,270	58,424,860
Llogaritë e pagueshme	Viti 2024 (€)	Viti 2023 (€)
Obligimet ndaj kërkesave kreditore	2,084,595	1,112,135
Mallra dhe Shërbime	111,070	138,425
Gjithsej	2,195,665	1,250,560

7.2 BUXHETI OPERATIV I AKP-SË

Buxheti operativ i AKP-së përdoret për mbulimin e shpenzimeve administrative dhe operative të AKP-së, si pagat, mallrat dhe shërbimet. Ky buxhet mbahet i ndarë nga Fondet në Mirëbesim, duke siguruar që funksionimi i AKP-së të mos financohet nga paratë e privatizimit të ndërmarrjeve.

Buxheti vjetor i AKP-së për vitin 2024, i ndarë sipas Ligjit të Buxhetit, është 4.70 mil €, kurse buxheti i shpenzuar gjatë vitit 2024 është 4.55 mil €, apo 96.7% e buxhetit. Shpenzimet kryesore janë për paga dhe mëditje (3.46 mil €) dhe për mallra dhe shërbime (924,047 €).

PËRFORMANCA FINANCIARE PËR BUXHETIN E AKP-SË

Kategoria ekonomike	Buxheti 2024 (€)	Shpenzimet 2024 (€)	Buxheti i mbetur 2024 (€)	% e shpenzuar (€)	Shpenzime 2023 (€)	% e buxhetit 2023 (€)
Pagat & mëditjet	3,466,805	3,466,481	324	93.99%	3,619,603	100%
Mallrat dhe shërbimet	1,027,882	924,047	103,835	89.90%	879,369	81%
Shërbimet komunale	150,000	106,178	43,822	70.79%	82,572	55%
Subvencionet dhe transferet	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet kapitale	60,000	56,188	3,812	93.65%	12,700	81%
Gjithsej	4,704,687	4,552,894	151,793	96.77%	4,594,244	94%

KAPITULLI 8: FUNKSIONET E PËRGJITHSHME

Ky kapitull përshkruan funksionet mbështetëse të AKP-së, të cilat sigurojnë operimin efikas dhe në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullative. Funksionet e përgjithshme kryhen nga departamente dhe divizione specifike, secili me përgjegjësi të qarta në menaxhimin e shërbimeve ligjore, administratës së përgjithshme, burimeve njerëzore, prokurimit, marrëdhënieve me publikun dhe auditimit të brendshëm.

8.1 Departamenti ligjor

Departamenti Ligjor i AKP-së luan një rol kyç në sigurimin që proceset e privatizimit dhe likuidimit zhvillohen në përputhje me ligjet, standardet dhe rregulloret e zbatueshme. Gjatë vitit 2024, ky departament ka përfaqësuar AKP-në në procedura gjyqësore dhe administrative, ka përgatitur dhe shqyrtuar kontrata të shitjes, ka ofruar këshilla juridike, si dhe ka shqyrtuar ankesat ndaj listave fillestare të 20%-shit të punëtorëve.

Përfaqësimi Ligjor dhe Procedurat Gjyqësore: Departamenti Ligjor ka përfaqësuar AKP-në në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe në gjykatat tjera në një numër çështjesh, përfshirë kontestet pronësore, mosmarrëveshjet kontraktuale, ankesat ndaj vendimeve të AKP-së, ekzekutimin e detyrimeve financiare etj. Gjatë vitit 2024, ka marrë pjesë në 276 seanca gjyqësore në 263 konteste apo lëndë aktive. Dhoma e Posaçme ka nxjerrë 33 aktgjykime / aktvendime përfundimtare. Gjithashtu, Departamenti Ligjor ka dhënë përgjigje ndaj urdhrave të gjykatave (84), padive (68), ankesave (43), kërkesave për masa të sigurisë (30), si dhe ka parashtruar ankesa në gjykata (24). Aktualisht në Dhomën e Posaçme janë 11,826 lëndë aktive në Kolegjet e Shkallës së Parë (Kolegjet e Specializuara) dhe 990 lëndë tjera aktive me ankesë në Kolegjin e Apelit (shkalla e dytë dhe përfundimtare).

Përgatitja e kontratave të shitjes: Gjatë vitit 2024, janë hartuar 91 kontrata të shitjes. Prej tyre, 49 kontrata të shitjes së aseteve me tender, shtatë (7) kontrata të shitjes direkte, dhe 35 kontrata të shitjes së banesave.

Shqyrtimi i ankesave të 20%-shit të punëtorëve: Gjatë vitit 2024, janë shqyrtuar 109 ankesa ndaj listave fillestare të publikuara për përfitimin e fondeve të 20%-it. Prej tyre, 42 ankesa janë aprovuar, 67 janë refuzuar.

Ofrimi i opinioneve dhe këshillave ligjore: Departamenti Ligjor ka ofruar mendime dhe këshilla ligjore, ka përgatitur dhe shqyrtuar rregullore dhe akte tjera juridike, si dhe ka marrë pjesë në komisione të brendshme.

8.2 Departamenti i administratës

Departamenti i Administratës është thelbësor për menaxhimin e aktiviteteve dhe shërbimeve mbështetëse që siguron se të gjitha operacionet e tjera të AKP-së mund të realizohen pa pengesa. Roli i tij përfshin administrimin e teknologjisë informative (TI), menaxhimin e zyrave dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës, menaxhimin e dokumentacionit dhe arkivimin e të dhënave, menaxhimin e resurseve

dhe pajisjeve të zyrës si dhe mbështetje logjistike, si organizimi i aktiviteteve, transporti, përkthimi, pastrimi dhe siguria.

Shërbime të teknologjisë informative: TI ka menaxhuar me sistemin e shërbimeve, rrjetit dhe komunikimeve dhe të desktop kompjuterëve. Gjatë vitit 2024 është përmirësuar sistemi i TI-së, duke përdorur softuerë të avancuar për menaxhimin e informacionit dhe dokumenteve, si Windows Server 2019, Microsoft Exchange 2019, si dhe databazat për protokoll, burime njerëzore dhe shkresa gjyqësore. Kjo ka mundësuar që informacioni të ruhet dhe të trajtohet në mënyrë më të shpejtë dhe të sigurt.

Menaxhimi i dokumentacionit dhe arkivave: Janë organizuar dhe menaxhuar dokumente të rëndësishme për privatizimin dhe aktivitete tjera të AKP-së, si dhe janë implementuar sisteme për ruajtjen dhe qasjen e informacionit në mënyrë efikase. Gjatë vitit 2024 janë regjistruar mbi 2,000 dokumente në databazën e arkivit dhe janë bërë përgatitjet për bartjen e dokumentacionit nga 5 arkivat rajonale të AKP-së në arkivin shtetëror.

Protokollimi i dokumentacionit: Gjatë vitit 2024 janë protokolluar mbi 8,200 shkresa gjyqësore, si dhe 3,500 shkresa tjera administrative hyrëse dhe 2,500 shkresa administrative dalëse.

Ofrimi i shërbimeve të përgjithshme: është siguruar menaxhimi i rregullt dhe me kohë i objekteve, furnizimeve, pajisjeve, dhe pasurisë së AKP-së. Gjatë vitit 2024 janë trajtuar kërkesat për material higjienik, administrativ dhe inventar, për riparime të ndryshme, fatura dhe raporte të pranimit.

Menaxhimi i transportit: AKP ka gjithsej 25 vetura të veta, shumica janë të vjetra dhe kërkojnë servisim të shpeshtë. Përveç tyre, janë përdorur edhe 7 vetura tjera me qira bazuar në kontratën e AQP-së. Gjatë vitit 2024 janë realizuar mbi 900 kërkesa për transport të stafit dhe 1,336 për transport të materialit.

Duhet theksuar se shumë procese administrative të AKP-së varen nga institucionet tjera publike. Mos ofrimi i shërbimeve të tyre me kohë dhe cilësi ka ndikim në performancën e përgjithshme të AKP-së. Si shembull, AKP furnizohet me mallra dhe shërbime të caktuara sipas tenderimit të centralizuar dhe kontratave të nënshkruara nga AQP. Vonesa e AQP-së në zhvillimin e procedurave tenderuese paraqet sfida për AKP-në.

| 8.3 Burimet njerëzore

Në fund të vitit 2024 AKP kishte gjithsej 206 nëpunës (pa llogaritur 8 anëtarët e Bordit). Prej tyre, rreth 52% ishin të angazhuar në aktivitete operative, ndërsa 48% në funksione të përgjithshme apo administrative.

Sipas gjinisë, 54.75% janë meshkuj, dhe 45.24% janë femra. Sipas nivelit të edukimit, 2 nëpunës (0.90%) janë me doktoraturë, 55 (14.8%) me studime pas universitare, 130 (58.8%) me studime universitare, 4 (1.8%) me shkollë të lartë dhe 17 (7.7%) me edukim të mesëm. Moshë mesatare e nëpunësve është 44 vjet. I gjithë personeli i AKP-së ka statusin e zyrtarëve publik.

Pozitat udhëheqëse të AKP-së, të ndara sipas kategorive profesionale, janë si më poshtë:

- ♦ 3 zyrtarë të Kategorisë së Lartë Drejtuese (Drejtori Ekzekutiv, Zëvendës Drejtori Ekzekutiv për Operativë dhe Zëvendës Drejtori Ekzekutiv për Funksione të Përgjithshme);

- ◇ 6 zyrtarë të Kategorisë së Mesme Drejtuese (Drejtorë të Departamenteve²⁵);
- ◇ 28 zyrtarë të Kategorisë së Ulët Drejtuese²⁶

Ndërsa, pozitat operative dhe administrative, të kategorisë profesionale, janë si më poshtë:

- ◇ 10 zyrtarë të kategorisë së specialistëve (pozitat Zyrtarë për Kadastër);
- ◇ 174 zyrtarë të kategorisë profesionale (klasifikimi Profesional 1 dhe Profesional 2).

Gjatë vitit 2024, 16 zyrtarë kanë ndjekur trajnime profesionale me qëllim të zhvillimit profesional dhe rritjes së performancës organizative. Trajnimet janë organizuar nga shoqata dhe institucione vendore.

Lëvizja e stafit

Gjatë vitit 2024, AKP ka pasur një numër të rekrutimeve të reja dhe të dorëheqjeve të stafit profesional dhe menaxhuese. Po ashtu, një numër i personelit është transferuar nga pozitat e tyre aktuale në pozita tjera brenda AKP-së për t'i plotësuar pozitat e zbrazëta të krijuara nga lëvizja e stafit si dhe për të adresuar volumin e rritur të aktiviteteve në fushat operative.

Pas procedurave të zhvilluara të rekrutimit dhe me rekomandim të komisionit të pranimit, Bordi i Drejtorëve ka emëruar Zëvendësdrejtorin Ekzekutiv për Operativ (në korrik) dhe Zëvendësdrejtorin Ekzekutiv për Funksione të Përgjithshme (në shtator).

Në muajin nëntor, Drejtori Ekzekutiv i AKP-së ka dhënë dorëheqje, ndërsa BiD ka emëruar Zëvendësdrejtorin Ekzekutiv për Funksione të Përgjithshme si ushtrues detyre i Drejtorit Ekzekutiv deri në përzgjedhje të drejtorit të ri. Konkursi për rekrutim të Drejtorit Ekzekutiv është shpallur dhe deri në datën e publikimit të këtij raporti nuk ka përfunduar.

Po ashtu, me vendim të Menaxhmentit janë rekrutuar:

- ◇ Zyrtar për Kadastër në ZQ Prishtinë (një pozitë);
- ◇ Pastruese në Divizionin e ZR Pejë (një pozitë).

Ndërsa, kanë dhënë dorëheqje 7 zyrtarë, janë transferuar brenda AKP-së 25 zyrtarë (16 transfere të përkohshme dhe 9 transfere të përhershme), si dhe 4 zyrtar janë në listë të pritjes si rezultat i ri-organizimit të vitit 2023. Sistematizimi i tyre, sipas ligjit për zyrtarët publik, nuk ka përfunduar ende.

Më poshtë është paraqitur përmbledhja e lëvizjeve të Stafit të AKP-së:

LËVIZJET E STAFIT GJATË VITIT 2024

Rekrutimet	Dorëheqjet	Pensionimet		Pushim pa pagesë	Pushim Lehonie	Ushtrues detyre	Transferimet	
		Sipas moshës	Para kohëshme				Përkohshme	Përhershme
4	7	4	1	8	5	15	16	9

²⁵ Sipas strukturës organizative të aprovuar në vitin 2023, janë 6 drejtorë të departamenteve, si në vijim: 1) Drejtori i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve, 2) Drejtori i Departamentit të Koordinimit Rajonal dhe Operativës, 3) Drejtori i Departamentit Ligjor, 4) Drejtori i Departamentit të Financave dhe Buxhetit, 5) Drejtori i Departamentit të Administratës, dhe 6) Drejtori i Departamentit të Auditimit të Brendshëm.

²⁶ Udhëheqësi i divizionit të burimeve njerëzore, udhëheqësi i divizionit të prokurimit, dhe 26 udhëheqës tjerë të divizioneve operative dhe të funksioneve të përgjithshme).

8.4 Prokurimi

Aktivitetet e prokurimit realizohen nga divizioni i prokurimit. Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar gjithsej 29 aktivitete prokurimi dhe janë nënshkruar 26 kontrata, të cilat kryesisht kanë qenë për furnizime me mallra dhe kryerje të shërbimeve.

Numri i kontratave të nënshkruara dhe vlera e tyre është paraqitur në tabelë.

REALIZIMI I AKTIVITETEVE TË PROKURIMIT GJATË VITIT 2024

Lloji i kontratave	Numri i kontratave	Shuma e kontratave (€)
Furnizimi me mallra	11	96,565.90
Shërbime	15	458,985.88
Gjithsej	26	555,551.78

8.5 ZYRA PËR MEDIA DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun në AKP luan një rol të rëndësishëm në mbështetje të komunikimit dhe transparencës gjatë proceseve të privatizimit dhe likuidimit. Kjo zyre është përgjegjëse për ndihmën në krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të mira dhe pozitive me publikun, mediat, qytetarët, investitorët dhe palët e tjera të interesuara, duke siguruar një komunikim të hapur, transparent dhe të besueshëm.

Këtë e bënë duke përdorur komunikata për shtyp, raporte publike, platforma online dhe rrjete sociale për të informuar publikun dhe mediat për zhvillimet dhe aktivitetet e AKP-së dhe për të rritur transparencën.

Gjatë vitit 2024, janë publikuar 28 komunikata për media, 15 artikuj të sponsorizuar, si dhe 105 postime në rrjete sociale dhe web faqe të AKP-së. Gjithashtu janë dhënë 73 përgjigje për media, janë trajtuar 360 kërkesa të palëve të jashtme të paraqitura përmes emailit zyrtar të AKP-së, si dhe 28 kërkesa për qasje në dokumente publike. Përmes këtyre aktiviteteve, zyra ka zhvilluar raporte të mira me publikun dhe ka mbështetur proceset e AKP-së në një mënyrë të hapur dhe të drejtë.

8.6 AKTIVITETET E MARKETINGUT

Aktivitet e marketingut kryhen nga divizioni i marketingut të AKP-së. Ky divizion ka një rol strategjik në promovimin dhe mbështetjen e procesit të privatizimit, likuidimit dhe të shërbimeve që ofron AKP. Gjithashtu, ky divizion siguron që të gjitha informacionet lidhur me privatizimin dhe likuidimin e NSh-ve dhe aseteve të jenë të disponueshme dhe të kuptueshme për palët e interesuara, përfshirë qytetarët dhe investitorët. Këtë e bënë duke përdorur kanale të ndryshme komunikimi, përfshirë mediat sociale, evente dhe takime direkte, si dhe komunikim përmes materialeve informuese dhe promovuese.

Gjatë vitit 2024, në mbështetje të procesit të privatizimit dhe likuidimit, janë realizuar 37 publikime të rëndësishme për informim të publikut, përfshirë shpalljet për shitjen e aseteve dhe qiradhënie, raportet përfundimtare të likuidimit, listat e punëtorëve për shpërndarjen e 20% dhe njoftimet për kreditorë. Publikimet u bënë në televizionin publik (RTK), portalet mediale dhe faqen zyrtare të AKP-së.

Edhe në këtë vit, përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve të ofruara për blerësit potencial ka vazhduar të jetë ndër prioritetet e AKP-së. Në këtë drejtim, për të lehtësuar qasjen në informata, AKP për herë të parë përdori aplikacionin Google Maps për të ofruar informacion të detajuar mbi vendndodhjen dhe karakteristikat e aseteve që janë në proces të shitjes. Kjo ka ndihmuar blerësit potencial të kenë informata për lokacionin e aseteve pa pasur nevojë për vizita fizike në teren. Ky zhvillim ka përmirësuar ndjeshëm përvojën e përdoruesve, duke e bërë procesin më transparent dhe efikas. Në të njëjtën kohë, është ofruar qasje në dosjet e tenderit për 210 asete.

Po ashtu, është siguruar që web faqja zyrtare e AKP-së të ofrojë informacion të përditësuar dhe të qartë për proceset e shitjeve dhe mundësitë për investitorët. Përmes web faqes janë shpërndarë informatat për procesin e privatizimit, likuidimit dhe punën e AKP-së. Web faqja është përditësuar në mënyrë të vazhdueshme me të gjitha njoftimet dhe dokumentet e rëndësishme. Gjatë vitit janë publikuar 37 shpallje, janë regjistruar 197 njoftime për shitje dhe qiradhënie të aseteve, janë postuar 1,128 dokumente, foto dhe video, si dhe lajme, njoftime, dhe është azhurnuar përmbajtja e postimeve (446).

8.7 Auditimi i brendshëm

Divizioni i Auditimit të Brendshëm (DAB) ka arritur që të përmbushë planin e vet të punës për periudhën janar-dhjetor 2024. Për periudhën raportuese, DAB ka arritur t'i finalizoj 9 raporte të auditimit përfshirë raportin e auditimit mbi përcjelljen e implementimit të rekomandimeve të vitit 2023, Fokusi i auditimeve të kryera ka qenë në forcimin e sistemit të kontroleve të brendshme, përmirësimin e menaxhimit dhe efikasitetit në punë, shmangien e gabimeve të mundshme, rritjen e vlerës dhe raportimin e parregullsive dhe gabimeve me qëllim që t'i ofrohet siguria Bordit dhe menaxhmentit për funksionimin efikas të aktiviteteve operative dhe funksioneve të përgjithshme të AKP-së.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur auditimet e kryera gjatë vitit 2024:

AUDITIMET E KRYERA GJATË VITIT 2024

Nr	Fushat e audituara	Periudha
1	Procesi i menaxhimit të të hyrave nga qiratë	TM1/2024
2	Procesi i ofrimit të mbështetjes profesionale lidhur me çështjet kadastrale dhe pronësore	TM1/2024
3	Procesi i shqyrtimit të listave dhe shpërndarja e mjeteve të 20%-it të punëtorëve	TM2/2024
4	Menaxhimi i procesit të likuidimit të NSh-ve dhe zbatimi i kontratës me OShP-në	TM2/2024
5	Procesi i shitjes së aseteve përmes tenderit publik	TM3/2024
6	Procedurat e shitjes së aseteve përmes negocimit direkt	TM3/2024
7	Menaxhimi i procedurave të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave	TM4/2024
8	Menaxhimi i fondeve të buxhetit të AKP-së dhe Fondeve në Mirëbesim	TM4/2024
9	Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të dhëna gjatë vitit 2023	TM4/2024

Përveç auditimeve të paraqitura më lart, divizioni ka ndërmarr edhe aktivitete tjera, si në vijim:


- ♦ Pjesëmarrja në takimet e Komitetit të Auditimit: janë mbajtur 6 takime, ku janë diskutuar raportet e DAB-së për vitin 2024 si dhe implementimi i rekomandimeve të auditimit;
- ♦ Përgatitja e planit vjetor të punës së Divizionit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2025. Plani është aprovuar nga BiD / Komiteti i Auditimit dhe është dorëzuar tek Departamenti Qendror Harmonizues në kuadër të MFPT-së brenda afateve të përcaktuara ligjore;
- ♦ Përgatitja e raporteve periodike (gjashtëmujore dhe vjetore) mbi aktivitetet e Divizionit të Auditimit të Brendshëm dhe dorëzimi i tyre tek Departamenti Qendror Harmonizues në kuadër të MFPT-së.

SHTOJCAT

1. STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT;
2. LISTA E NDËRMARRJEVE TË LIKUIDUARA;
3. PJESA TEKSTUALE E RAPORTIT FINANCIAR SIPAS FORMATIT TË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS;
 - 3.1. SHËNIMET SHPJEGUESE PËR MALLRA 2024;
4. PJESA TABELARE E RAPORTIT FINANCIAR SIPAS FORMATIT TË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS;
5. PASQYRAT FINANCIARE TË BUXHETIT VJETOR TË AGJENCISË;
6. PASQYRAT FINANCIARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Versioni:
26 qershor 2023



LISTA E NSh-ve TË LIKUIDUARA

Nr.	PAK ID	Emri i ndërmarrjes	Rajoni	Data e dorëzimit në Bordin e Drejtorëve	Data e dorëzimit në DHPGJSK	Data e pranimit të vendimit nga DHPGJSK	Numri i vendimit të DHPGJSK	OSHP/AKP
1	GJI016	K.B "Kishna Pole"	Gjilan	25-Jul-18	2-Aug-18	29-Mar-21	C-IV-18-0066	Njësia e AKP-së
2	GJI019	K.B "Perlepnica"	Gjilan	29-Mar-19	15-Apr-19	27-May-19	C-IV.-19-0004	Njësia e AKP-së
3	GJI054	N.P.SH.T."Metalografika"	Gjilan	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0074	OSHP
4	GJI074	Barnatorja Gjilan (pharmacy)	Gjilan	25-Jul-18	6-Aug-18	1-Jul-22	C-IV-18-0076	OSHP
5	GJI108	N.Sh.T "Fertrans"	Gjilan	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0079	OSHP
6	GJI128	Agrokultura/Ferizaj	Gjilan	30-Mar-17	11-Apr-17	21-Jun-17	C-IV.-17-0018	Njësia e AKP-së
7	GJI130	Bibaj	Gjilan	17-May-16	18-Jul-16	24-Aug-16	C-IV.-13-0333	Njësia e AKP-së
8	GJI134	Gacke	Gjilan	23-Nov-16	25-Jan-17	21-Jan-17	C-IV.-17-0004	Njësia e AKP-së
9	GJI136	KB Bujku Kosina	Gjilan	25-Sep-20	20-Sep-20	17-Dec-20	C-IV-20-0060	Njësia e AKP-së
10	GJI143	Visoca	Gjilan	21-Sep-16	23-Sep-16	14-Oct-16	C-IV.-16-0381	Njësia e AKP-së
11	GJI144	Xhafa	Gjilan	31-Aug-16	21-Sep-16	30-Sep-16	C-IV.-16-0371	Njësia e AKP-së
12	GJI151	Vet Station - Ferizaj/Urosecvac	Gjilan	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0072	OSHP
13	GJI154	Cinema Gjilan	Gjilan	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0081	OSHP
14	GJI156	Universiteti i Punetoreve/Cinema - Ferizaj	Gjilan	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0082	OSHP
15	GJI157	N.N. 16 Nentori	Gjilan	27-Apr-17	2-Apr-17	21-Jun-17	C-IV.-17-0034	Njësia e AKP-së
16	GJI169	Partizan, Babush	Gjilan	22-Nov-18	4-Dec-18	30-Jan-19	C-IV.-18-0094	Njësia e AKP-së
17	MIT004	KB Bujku	Mitrovica	23-Oct-21	2-Dec-21	24-Mar-22	C-IV-21-0225	OSHP
18	MIT006	KB Likovci	Mitrovica	20-Jul-12	16-Aug-12	11-Jan-13	C-IV-12-0015	Njësia e AKP-së
19	MIT007	KB Liria	Mitrovica	20-Jul-12	16-Aug-12	31-Jan-13	C-IV-12-0016	Njësia e AKP-së
20	MIT017	Graniti	Mitrovica	20-Jul-12	16-Aug-12	10-Dec-12	C-IV-12-0017	Njësia e AKP-së
21	MIT032	Stacioni i Veterinës Skenderaj	Mitrovica	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0070	OSHP

22	MIT046	N.P.SH.T DEN	Mitrovica	-	4-Sep-13	6-Nov-17	C-IV-13-1675	OSHP
23	MIT075	SH.A.M. Ruzhdi Bytyqi	Mitrovica	31-Jan-14	4-Feb-14	13-Mar-14	C-IV-14-0109	Njësia e AKP-së
24	MIT098	Hidrotermika	Mitrovica	20-Jul-12	16-Aug-12	15-Oct-12	C-IV-12-0018	Njësia e AKP-së
25	MIT164	Ndermarrja Ndertimore Ndertimtari	Mitrovica	30-Jun-22	19-Jul-22	3-Aug-22	C-IV-22-0215	Njësia e AKP-së
26	MIT141	Konfekcioni Rashka	Mitrovica	23-Oct-21	2-Dec-21	11-Jan-24	C-IV-21-0224	OSHP
27	PEJ010	Fabrika e ushqimit te kafshëve Klinapremix	Peja	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0083	OSHP
28	PEJ011	Fabrika e Farës Dardania	Peja	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0071	OSHP
29	PEJ012	Fabrika e Kërpudhave Shampinjoni i Kosovës	Peja	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0080	OSHP
30	PEJ049	Koop. Bujqësore Ozdrim	Peja	19-Dec-13	26-Dec-13	27-Feb-14	C-IV.-13-3950	Njësia e AKP-së
31	PEJ053	Koop. Bujqësore Vitomirica	Peja	26-May-16	18-Jul-16	1-Aug-16	C-IV.-16-0332	Njësia e AKP-së
32	PEJ145	Dardania	Peja	22-Nov-21	10-Dec-21	15-Apr-22	C-IV-21-0234	OSHP
33	PEJ184	NT Petrans Pejë/Pec	Peja	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0078	OSHP
34	PRN013	KB ORLLAN	Prishtina	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0075	OSHP
35	PRN059	KOSOVA CONTROL	Prishtina	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0077	OSHP
36	PRZ030	Ndertimi	Prizren	25-May-17	6-Jun-17	31-Jul-17	C-IV.-17-0114	Njësia e AKP-së
37	PRZ051	N.SH.Auto Moto	Prizren	17-May-16	18-Jul-16	2-Aug-16	C-IV.-16-0331	Njësia e AKP-së
38	PRZ056	SHAM Semafor	Prizren	27-Jun-13	28-Jun-13	17-Jan-14	C-IV.-13-1068	Njësia e AKP-së
39	PRZ072	KB Mushtishti-Mushtisht (Suhareka)	Prizren	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0073	OSHP
40	PRZ076	OLT -Osijek NJP Rahovec	Prizren	28-Jul-22	22-Aug-22	4-Jan-23	C-IV.-22-0295	OSHP
41	PRZ085	KB Lubizhda Malishevë	Prizren	28-Jul-22	5-Aug-22	11-Dec-23	C-IV-22-0283	Njësia e AKP-së
42	PRZ089	KB Vlashki Drenovc Malishevë	Prizren	25-Jul-18	2-Aug-18	29-Mar-21	C-IV-18-0067	Njësia e AKP-së
43	PRZ087	KB Zocishta Zogishtë Rahovec	Prizren	29-Oct-21	15-Nov-21	19-Nov-21	C-IV-21-0214	Njësia e AKP-së
44	PRZ090	KB Hoqa e Qytetit	Prizren	31-May-22	9-Jun-22	11-Dec-23	C-IV-22-0163	Njësia e AKP-së
45	PRZ091	KB Opterusha	Prizren	29-Oct-21	15-Nov-21	19-Nov-21	C-IV-21-0215	Njësia e AKP-së

46	PEJ017	Ag Coop "Prapaçani" Prapaçan	Peja	30-Nov-22	8-Dec-22	18-Apr-23	C-IV-22-0411	Njësia e AKP-së
47	PEJ048	Ag coop Kuqishte	Peja	30-Nov-22	7-Dec-22	19-Dec-23	C-IV-22-0410	OSHP
48	PEJ078	"Fabrika e Pompave me Piston"	Peja	29-Mar-23	30-May-23	17-Jan-24	C-IV-23-0115	OSHP
49	GJI082	G.T. Grafikos	Peja	29-May-23	13-Jul-23	17-Jan-24	C-IV-23-0124	OSHP
50	PEJ186	DES Bratstvo	Peja	29-Jun-23	13-Jul-23	21-Mar-24	C-IV-23-0125	OSHP
51	GJI152	Stacioni i Veterinarisë	Prizren	30-Oct-23	4-Dec-23	3-Jan-24	C-IV-23-0687	OSHP
52	PRZ061	Ambulanca Veterinare	Prizren	30-Oct-23	4-Dec-23	4-Jun-24	C-IV-23-0688	OSHP
53	PEJ054	KB Zahaq	Peja	21-Dec-23	28-Dec-23	9-Feb-24	C-IV-23-0712	Njësia e AKP-së
54	PEJ207	Auto Moto Rival	Peja	21-Dec-23	28-Dec-23	7-Feb-24	C-IV-23-0713	Njësia e AKP-së
55	MIT148	Muharrem Bekteshi	Mitrovica	27-Jun-24	3-Jul-24	10-Jul-24	C-IV-24-0106	Njësia e AKP-së
56	GJI150	Stacioni i Veterines - Kaçanik	Gjilan	27-Jun-24	15-Jul-24	2-Aug-24	C-IV-24-0110	OSHP
57	MIT034	Trepça Konfeksioni	Mitrovica	27-Jun-24	15-Jul-24	27-Aug-24	C-IV-24-0108	OSHP
58	MIT152	Bagat Beograd	Mitrovica	27-Jun-24	15-Jul-24	27-Aug-24	C-IV-24-0111	OSHP
59	PRZ092	KB Mamusha	Prizren	19-Aug-24	5-Sep-24	21-Oct-24	C-IV-24-0155	Njësia e AKP-së



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Vula pranuese e Njesisë për
Propozime dhe Parashtresa

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
- Raporti Financiar për vitin 2024

Kodi i Organizatës Buxhetore: 239

Informatat kontaktuese:

Zyrtari Kryesor Administrativ: Ibrahim Gjylderen, u.d. Drejtor Ekzekutues

Rr. Dritan Hoxha Nr. 55, 10000 Prishtinë, Tel, 038 500 400 E-mail: Ibrahim.Gjylderen@pak-ks.org

Zyrtari Kryesor Financiar: Adem Selishta, Drejtor i Financave dhe Buxhetit,

Rr. Dritan Hoxha Nr. 55, 10000 Prishtinë, Tel, 038 500 400 E-mail: adem.selishta@pak-ks.org

Data: 07.02.2025

1) Hyrje:

Në mungesë të mjeteve nga tarifa e të Hyrave të Dedikuara buxheti i AKP-së për vitin 2024 është financuar nga Granti Qeveritar (GQ).

Buxheti fillestar i AKP-së për vitin fiskal 2024, i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, është në vlerën prej EUR 4,575,686.00, ndërsa buxheti përfundimtar, pas kursimeve dhe ndërrimeve në buxhet është EUR 4,704,685.82.

Realizimi përfundimtar i buxhetit të vitit 2024 është gjithsej 96.77%

Teprica e buxhetit të pa shpenzuar është EUR 151,791.55 dhe kryesisht i përket kategorisë ekonomike të shërbimeve komunale dhe kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

2) Përmbledhje për të hyrat dhe kategoritë e veçanta të shpenzimeve:

a) Të hyrat:

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2024 kemi identifikuar kursime buxhetore në vlerë prej EUR 246,500.00. mirëpo për shkak se në këtë vit nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) nuk ka pasur instruksion (proces) të rishikimit gjysmë vjetor, kursimet e identifikuara i kemi paraqitur gjatë përmbylljes së vitit fiskal sipas kërkesës MFPT dhe njëkohësisht kemi kërkuar që mjetet e kursyera të reduktohen nga buxheti i Agjencisë.

Sipas kërkesës së AKP-së, MFPT përmes Vendimit të Qeverisë Nr. 14/238 ka aprovuar kursimet dhe ka reduktuar buxhetin.

b) Pagat dhe mëditjet:

Gjithsej numri i punëtorëve dhe Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve i aprovuar sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2024 është 242.

Shpenzimet për paga dhe mëditje përfshijnë pagat bruto dhe kontributet për nëpunësit e AKP-së si dhe kompensimin e 8 anëtarëve të bordit të AKP-së.

Në kategorinë paga dhe mëditje buxheti fillestar ka qenë EUR 3,091,304.00 ndërsa ai përfundimtar është EUR 3,466,804.22.

Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese Nr. AGJ 2316/24, përkitazi me çështjen e pagave, pagat e AKP-kanë vazhduar të realizohen pa zbritjen e shtesës tranzitore prej 50%. Duke u bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, MFPT përmes vendimit të Qeverisë nr. 14/238 dhe 16/174 ka alokuar buxhetin shtesë prej EUR 375,500.22 për të mundësuar realizimin e pagave të stafit të AKP-së deri në fund të vitit 2024.

Gjithsej shpenzimi i buxhetit në kategorinë e pagave është EUR 3,466,480.97. Realizimi i buxhetit në këtë kategori është 99.99%.

Pagat dhe mëditjet e zyrtareve të AKP-së sipas listës së pagave procedohen përmes Divizionit të Pagave në kuadër të Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. AKP dërgon listat e punëtorëve (stafit të saj) për periudhat përkatëse në këtë divizion dhe nga i cili procedohen pagesat në llogaritë përkatëse të punëtorëve të AKP-së. Pagesat për kontributin e punëdhënësit dhe tatimin në burim realizohen direkt në Administratën Tatimore të Kosovës.

Shpenzimet për Pagat Bruto dhe kontributet për nëpunësit e AKP-së për vitin 2024 janë gjithsej EUR 3,247,459.97.

Buxheti i shpenzuar për kompensimin e Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, Komitetit të Auditimit dhe Komisionit për vlerësim të pëformancës së Menaxhmentit për vitin 2024 është EUR 217,550.

Ndërsa, EUR 1,471 janë shpenzime të ekspertëve të jashtëm të angazhuar në hapje të ofertave për valët e privatizimit dhe ekspertëve të angazhuar si anëtar të komisionit sipas Ligjit për rekrutimin e pozitive të larta. Kompensimi dhe Kontributet e pagesave të Bordit janë realizuar nga kodi ekonomik "Funksionarët me kohë të pjesshme" (11441).

Buxheti i shpenzuar për këtë kategori për vitin 2024 është EUR 219,021.18.

c) Mallra dhe Shërbime:

Buxheti i aprovuar fillestar nga Granti Qeveritar (GQ) në kategorinë mallra dhe shërbime është EUR 1,069,382.00 ndërsa ai përfundimtar EUR 1,027,882.00.

Diferenca prej EUR 41,500 është rezultat kursimeve buxhetore të cilat AKP i ka paraqitur pranë MFPT-së me datën 19 nëntor 2024.

Fondet e aprovuara në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime kanë qenë të destinuara:

- Për të mbuluar shpenzimet operative dhe administrative;
- Mbulimin e shpenzimeve të procesit të Privatizimit dhe Likuidimit;
- Për të mbështetur në aspektin ligjor procesin e privatizimit dhe likuidimit;

Në tremujorin e fundit të vitit 2024 në kategorinë mallra dhe shërbime kemi identifikuar kursime buxhetore në vlerë prej EUR 41,500 të cilat gjatë përmbylljes së vitit fiskal i kemi paraqitur pranë MFPT-së dhe njëkohësisht kemi kërkuar që mjetet e kursyera të reduktohen nga buxheti i Agjencisë.

Rrjedhimisht, MFPT ka aprovuar kursimet dhe ka zbritur buxhetin sipas vendimit të Qeverisë nr. 14/238.

Gjithsej mbetja e buxhetit të pashepenzuar (pas kurimeve) për vitin 2024 është EUR 103,834.91.

Realizimi përfundimtar i buxhetit në këtë kategori është gjithsej 89.90%

d) Shpenzime komunale:

Për periudhën raportuese, buxheti fillestar dhe përfundimtar i aprovuar për shërbime komunale është EUR 150,000. Buxheti i pa shpenzuar është EUR 43,821.79.

Arsyet kryesore të mbetjes së buxhetit të pa shpenzuar janë:

- AQ2- Rryma

Buxheti i pashpenzuar EUR 20,712.94.

Për shkak të krizës globale në energji dhe rrezikut të ngritjes së çmimeve kemi planifikuar buxhet më të lartë.

- AQ6- Ngrohja me Termokos

Buxheti i pashpenzuar EUR 10,892.67.

Kushtet klimatike kanë ndikuar në shpenzimet më të vogla të ngrohjes përgjatë sezonit dimëror.

Realizimi përfundimtar i buxhetit në këtë kategori është gjithsej 70.79%.

e) Investimet Kapitale:

Për periudhën raportuese, buxheti i aprovuar fillestar për shpenzime kapitale ka qenë EUR 260,000.00 ndërsa buxheti final është EUR 60,000.00.

Mjetet kanë qenë të destinuara për tri projekte kapitale:

- Blerja e pajisjeve të TI-së për ngritjen e cilësisë të shërbimeve, vlera EUR 20,000.00.

Projekti është realizuar dhe teprica e shumës së pa shpenzuar është EUR 702.00.

- Blerja dhe instalimi i barrierave optike me krah vlera EUR 40,000.00.

Projekti është realizuar dhe teprica e shumës së pa shpenzuar është EUR 3,110.00.

- Data baza e arkives së AKP-së (kodi i projektit 19256), vlera EUR 200,000.00.

Sipas afateve dhe rregullave bazuar në Ligjin dhe Rregulloren për Prokurim Publik, AKP ka shpallur tri herë tender i cili për shkak të ankesave në OSHP ka dështuar në të tri rastet dhe rrjedhimisht OSHP, më datën 20 gusht ka shpallur anulimin e tenderit.

Pasi që projekti nuk ka mundur të realizohet në vitin 2024, AKP ka kërkuar pranë MFPT të paraqitet si kursim dhe njëkohësisht është kërkuar që projekti të bartet në buxhetin e vitit 2025. Sipas vendimit të Qeverisë nr. 14/238 mjetet janë zbritur nga buxheti i AKP-së dhe po ashtu buxheti për projektin e njëjtë është bartur/aprovuar në Ligjin e buxhetit për vitin 2025.

Realizimi përfundimtar i buxhetit në këtë kategori është gjithsej 93.65%.

f) Subvencionet dhe Transferet:

Për periudhën raportuese, buxheti i fillestar për subvencione dhe transfere është EUR 5,000.00 ndërsa ai përfundimtar është zero.

Buxheti ka qenë i planifikuar për të mbështetur funksionin e Menaxhimit të Ndërmarrjeve Shoqërore që janë në Administrim Direkt të AKP-së me qëllim të ruajtjes dhe rritjes së vlerës së këtyre Ndërmarrjeve para privatizimit.

Në tremujorin e fundit mjetet janë paraqitur si kursime dhe si të tilla sipas vendimit të Qeverisë nr. 14/238 janë zbritur nga buxheti i AKP-së. Arsyeja e kursimit ka qenë sepse Ndërmarrjet kan pasur mjetet e tyre financiare dhe nuk ka pasur nevojë për mjete nga Granti Qeveritar.

3) Përmbledhje:

Buxheti fillestar i AKP-së për vitin fiskal 2024, i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, është në vlerën prej EUR 4,575,686.00 , ndërsa buxheti përfundimtar, pas kursimeve dhe buxhetit shtesë në kategorinë e pagave (sipas vendimeve të Qeverisë) është EUR 4,704,685.82.

Shpenzimi i buxhetit është EUR 4,552,894.27, ndërsa realizimi përfundimtar është gjithsej 96.77%.

Gjate implementimit të dhe rishikimit të buxhetit në tremujorin e fundit kemi identifikuar kursime në vlerë prej EUR 246,500, të cilat me datën 19 nëntor 2024 i kemi paraqitur pranë Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve (MFPT). Sipas Kërkesës sonë MFPT përmes Vendimeve të Qeverisë i ka zbritur shumat e kursimeve nga buxheti fillestar.

Gjithashtu në tremujorin e fundit MFPT duke u bazuar ne Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr. AGJ 2316/24, përkitazi me çështjen e pagave e cila i ka shpallë të pavlefshëm paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (shtesa tranzitore), pagat e AKP-kanë vazhduar të realizohen pa zbritjen e shtesës tranzitore prej 50%. Për të mundësuar realizimin e pagave deri në fund të vitit, MFPT përmes vendimit të Qeverisë nr. 14/238 dhe 16/174 ka alokuar buxhetin shtesë prej EUR 375,500.22.

Shuma e buxhetit të pa shpenzuar është gjithsej EUR 151,791.55.

Në renditjen e mëposhtme janë shpalosur disa nga linjat më relevante në të cilat ka pasur shpenzim më të ulët se sa planifikimi fillestar:

1. Shërbimet Komunale (rryma dhe ngrohja me termokos)
2. Derivate dhe lëndë djegëse (naftë për ngrohje qendrore, derivate për gjenerator, karburant dhe vaj për vetura;
3. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve;
4. Blerje e mobileve dhe pajisjeve (më pak se 1000 euro);
5. Mirëmbajtja e ndërtesave, mobileve dhe pajisjeve;
6. Shpenzimet për informim publik;

3.1 SHPJEGIME LIDHUR ME PERFORMANCEN E BUXHETIT NË KATEGORINË MALLRA DHE SHËRBIME DHE KRAHASIME ME VITET PARAPRAKE

Buxheti i aprovuar fillestar nga Granti Qeveritar (GQ) në kategorinë mallra dhe shërbime është EUR 1,069,382.00 ndërsa ai përfundimtar EUR 1,027,882.00.

Diferenca prej EUR 41,500 është rezultat kursimeve buxhetore të cilat AKP i ka paraqitur pranë MFPT-së me datën 19 nëntor 2024. Realizimi përfundimtar i buxhetit në këtë kategori është gjithsej 89.90%

Fondet e aprovuara në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime kanë qenë të destinuara:

- Për të mbuluar shpenzimet operative dhe administrative;
- Mbulimin e shpenzimeve të procesit të Privatizimit dhe Likuidimit;
- Për të mbështetur në aspektin ligjor procesin e privatizimit dhe likuidimit;

Në tremujorin e fundit të vitit 2024 në kategorinë mallra dhe shërbime kemi identifikuar kursime buxhetore në vlerë prej EUR 41,500 të cilat gjatë përmbylljes së vitit fiskal i kemi paraqitur pranë MFPT-së dhe njëkohësisht kemi kërkuar që mjetet e kursyera të reduktohen nga buxheti i Agjencisë. Rrjedhimisht, MFPT ka aprovuar kursimet dhe ka zbritur buxhetin sipas vendimit të Qeverisë nr. 14/238. Gjithsej mbetja e buxhetit të pashpenzuar (pas kurimeve) për vitin 2024 është EUR 103,834.91.

Në renditjen e mëposhtme janë shpalosur disa nga linjat më relevante në të cilat ka pasur shpenzim më të ulët se sa planifikimi fillestar:

1. Derivate dhe lëndë djegëse (naftë për ngrohje qendrore, derivate për gjenerator, karburant dhe vaj për vetura;
2. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve;
3. Blerje e mobiljeve dhe pajisjeve (më pak se 1000 euro);
4. Mirëmbajtja e ndërtesave, mobileve dhe pajisjeve;
5. Shpenzimet për informim publik;
6. Faza Tranzitore: Arkivimi i dokumenteve të Ndërmarrjeve Shoqërore (në pesë Zyrat Rajonale) pas privatizimit dhe derisa të përfundojë likuidimi;

Shumat e teprcës së buxhetit të pa shpenzuar janë të shpalosura te pasqyrat financiare të programeve përkatëse buxhetore.

Krahasuar me vitet paraprake që nga viti 2008, buxheti i aprovuar në këtë kategori ka vazhduar në mënyrë degresive të jetë për çdo vit më i ulët.

Mallra dhe Shërbime

4.c) DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

		Buxheti 2023			Buxheti 2024		
13000	Mallra dhe Shërbime Emri i kategorisë ekonomike	Planifikimi Janar - Dhjetor 2023	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2023	% e shpenzim eve	Planifikimi Janar - Dhjetor 2024	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2024	% e shpenzim eve
	Gjithsej	1,088,714	879,369	81%	1,027,872	924,047	90%
1310 SHPENZIMET E UDHËTIMIT (NËNTOTALI)		4,500	-	0%	3,900	1,963	50%
13130	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit	-	-	-	-	-	-
13131	Mëditja e udhëtim zyrtar brenda vendit	-	-	-	-	-	-
13132	Akomodimi gjatë udhëtimit zyrtar brenda vendit	-	-	-	-	-	-
13133	Shpenzimet tjera të udhëtimit zyrtar brenda vendit	4,500	-	-	-	-	-
13140	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	-	-	-	1,000	575	-
13141	Mëditja e udhëtim zyrtar jashtë vendit	-	-	-	200	184	-
13142	Akomodimi gjatë udhëtimit zyrtar jashtë vendit	-	-	-	700	475	-
13143	Shpenzimet tjera të udhëtimit zyrtar jashtë vendit	-	-	-	2,000	729	-
1330 SHËRBIMET E TELEKOMUNIKIMIT (NËNTOTALI)		24,910	23,547	95%	26,821	25,636	96%
13310	Shpenzimet për internet	6,400	5,675	89%	4,321	4,320	100%
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	17,461	16,899	97%	20,500	19,510	95%
13330	Shpenzimet postare	1,049	972	93%	2,000	1,806	90%
13340	Shpenzimet e përdorimit të kabllit optik	-	-	-	-	-	-
1340 SHPENZIMET PËR SHËRBIME (NËNTOTALI)		350,704	326,562	93%	348,100	330,904	95%
13410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	11,100	5,503	50%	9,000	8,594	95%
13420	Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës	-	-	-	-	-	0%
13430	Shërbime të ndryshme shëndetësore	-	-	-	-	-	0%
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse (nuk ka pasur pagesa nga ky kod ekonomik)	2,104	1,557	74%	-	-	0%
13450	Shërbime shtypje- jo marketing	500	136.50	27%	3,000	2,974	99%
Shërbime Kontraktuese Tjera							
13460	Në planin e ri kontabël në vitin 2024 është kod i ri ekonomik 13475 (sigurimi fizik i objekteve publike)sigurimin nga Policia e Kosovës të cilin e gjeni me poshtë tek kod i ri ekonomik 13475).	334,000	319,216	96%	59,000	52,092	88%
13470	Shërbime Teknike	3,000	150.00	5%	10,000	170	2%
13475	Sigurimi fizik i objekteve publike	-	-	-	267,100	267,074	100%
13480	Shpenzimet për Antaresim	-	-	-	-	-	0%
1350 BLERJE E MOBILJEVE DHE PAISJEVE (ME PAK SE 1000 EURO) (NËNTOTALI)		41,000	25,719	63%	40,500	33,897	84%
13501	Mobilje (më pak se 1000 euro)	6,000	5,190	87%	6,000	-	0%
13502	Telefona (më pak se 1000 euro)	-	-	-	-	-	0%
13503	Kompjuterë (më pak se 1000 euro)	-	-	-	28,000	27,928	100%
13504	Harduer për teknologji informative (me pak se 1000 euro)	20,000	6,298	31%	5,000	4,582	92%

Mallra dhe Shërbime

4.c) DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

13000	Mallra dhe Shërbime Emri i kategorisë ekonomike	Buxheti 2023			Buxheti 2024		
		Planifikimi Janar - Dhjetor 2023	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2023	% e shpenzim eve	Planifikimi Janar - Dhjetor 2024	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2024	% e shpenzim eve
13505	Makina fotokopjuese (me pak se 1000 euro)	-	-		-	-	
13506	Pajisje speciale mjeksore (më pak se 1000 euro)	-	-		-	-	
13507	Pajisje të shërbimit policor (më pak se 1000 euro)	-	-		-	-	
13508	Pajisje trafiku (më pak se 1000 euro)	-	-		-	-	
13509	Pajisje tjera (më pak se 1000 euro)	15,000	14,231	95%	1,500	1,388	93%
1360	BLERJE TJERA - MALLRA DHE SHËRBIME (NËNTOTALI)	56,000	53,418	95%	23,000	21,862	95%
13610	Furnizime për zyrë, Furnizim me materail administrative dhe letër për fotokopje	34,000	32,605	96%	8,000	7,767	97%
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	10,000	9,355	94%	8,000	7,229	90%
13630	Furnizime mjeksore	-	-		-	-	
13640	Furnizime pastrimi	12,000	11,459	95%	7,000	6,867	98%
13650	Furnizim me veshmbathje	-	-		-	-	
13660	Akomodimi	-	-		-	-	
13670	Municion dhe armë zjarri	-	-		-	-	
13680	Tiketë sigurorese(banderollat)	-	-		-	-	
13681	Bllombat	-	-		-	-	
1370	DERIVATET DHE LËNDËT DJEGËSE (NËNTOTALI)	47,000	36,718	78%	40,000	31,820	80%
13710	Vaj	-	-		-	-	
13720	Naftë për ngrohje qendrore	15,000	14,089	94%	5,000	4,450	89%
13730	Vaj për ngrohje	-	-		-	-	
13740	Mazut	-	-		-	-	
13750	Qymyr	-	-		-	-	
13760	Dru	-	-		-	-	
13770	Derivate për gjenerator	2,000	720.72	36%	5,000	-	
13780	Karburant për vetura	30,000	21,908	73%	30,000	27,371	91%

Mallra dhe Shërbime

4.c) DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

13000	Mallra dhe Shërbime Emri i kategorisë ekonomike	Buxheti 2023			Buxheti 2024		
		Planifikimi Janar - Dhjetor 2023	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2023	% e shpenzim eve	Planifikimi Janar - Dhjetor 2024	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2024	% e shpenzim eve
1380	LOGARITE E AVANSIT (NËNTOTALI)	3,000	1,000	33%	1,000	500	50%
13810	Avans për para të imëta (p.cash)	3,000	1,000	33%	1,000	500	50%
13820	Avans për udhetime zyrtare	-	-		-	-	
13821	Avans	-	-		-	-	
13830	Avans për mallra dhe shërbime	-	-		-	-	
13850	Avans - për ambasadat	-	-		-	-	
1390	SHËRBIMET FINANCIARE (NËNTOTALI)	-	-		-	-	
13911	Provizion Bankar-Banka Qendrore	-	-		-	-	
13912	Provizion Bankar-Raiffeisen Bank	-	-		-	-	
13913	Provizion Bankar-Procredit Banke	-	-		-	-	
13915	Provizion Bankar-Banka Private e Biznesit	-	-		-	-	
13916	Provizion Bankar-Banka Ekonomike	-	-		-	-	
13917	Provizion Bankar-NLB Banka Prishtina	-	-		-	-	
13918	Provizion për Tarifa të Ndryshme	-	-		-	-	
13940	KPA-Provizioni Bankar	-	-		-	-	
1395	SHËRBIMET E REGJISTRIMIT DHE SIGURIMEVE (NËNTOTALI)	10,300	10,101	98%	10,850	9,704	89%
13950	Regjistrimi i automjeteve	2,000	1,950	98%	3,000	1,925	64%
13951	Sigurimi i automjeteve	8,000	7,891	99%	7,600	7,529	99%
13952	Taksa komuale e regjistrimit të automjeteve	300	260	87%	250	250	100%
13953	Sigurimi i ndertesave dhe tjera	-	-		-	-	
1400	MIRËMBAJTJA (NËNTOTALI)	75,000	64,427	86%	74,427	76,962	103%
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	30,000	25,486	85%	25,000	18,688	75%
14020	Mirëmbajtja e ndertesave	2,000	1,200	60%	1,300	1,225	94%
14021	Mirëmbajtja e ndertesave të banimit	-	-		-	-	
14022	Mirëmbajtja e ndërtesave administrative afariste	-	-		1,000	985	99%
14023	Mirëmbajtja e shkollave	-	-		-	-	
14024	Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore	-	-		-	-	
14030	Mirëmbajtja e auto rrugeve	-	-		-	-	
14031	Mirëmbajtja e auto rrugeve regjionale	-	-		-	-	
14032	Mirëmbajtja e auto rrugeve lokale	-	-		-	-	
14040	Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative	26,000	21,635	83%	9,137	531	6%
14050	Mirëmbajtja e mobileve dhe paisjeve	17,000	16,105	95%	37,990	34,068	90%
13471	Softuerët - licencat dhe mirembajtja e tyre	-	-		22,000	21,465	98%

Mallra dhe Shërbime

4.c) DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

13000	Mallra dhe Shërbime Emri i kategorisë ekonomike	Buxheti 2023			Buxheti 2024		
		Planifikimi Janar - Dhjetor 2023	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2023	% e shpenzim eve	Planifikimi Janar - Dhjetor 2024	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2024	% e shpenzim eve
1410	QIRAJA (NËNTOTALI)	306,300	293,118	96%	330,074	294,188	89%
14110	Qiraja për ndërtesa	117,000	104,244	89%	117,000	92,224	79%
14120	Qiraja për tokë	-	-			-	
14130	Qiraja për paisje	300.00	300.00	100%	2,000	1,422	71%
14160	Qiraja për automjete				22,500	22,188	99%
14150	Qiraja për përdorime tjera hapësinore	189,000	188,574	100%	188,574	178,354	95%
1420	SHPENZIMET E MARKETINGUT (NËNTOTALI)	160,000	38,735	24%	94,000	63,387	67%
14210	Reklamat dhe konkurset	-	-		-	-	
14220	Botimet e publikimeve	-	-		10,000	118	1%
14230	Shpenzimet për informim publik	160,000	38,735	24%	84,000	63,269	75%
1430	SHPENZIMET E PËRFAQËSIMIT (NËNTOTALI)	10,000	6,024	86%	10,000	8,053	86%
14310	Shpenzimet e përfaqësimit mbrenda vendit (drekat zyrtare)	10,000	6,024	86%	10,000	8,053	81%
1440	SHPENZIME-VENDIMET E GJYKATAVE (NËNTOTALI)	-	-	0%	25,200	25,172	0%
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave (vendim përmbarrimor)	-	-		25,200	25,172	100%
1700	SERVISIMI I BORGJIT (NËNTOTALI)	-	-		-	-	
17000	Pagesa e borgjit qeveritar	-	-		-	-	



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**Agjencia Kosovare e Privatizimit
Kosovska Agencija za Privatizaciju**

RAPORTI VJETOR FINANCIAR

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024

PËRMBAJTJA

Neni 13: PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE	4
Neni 14: RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT	6
1.1. POLITIKAT KONTABËL	8
1.2. INFORMATA PËR ORGANIZATËN BUXHETORE.....	8
1.3. PAGESAT NGA PALËT E TRETA	9
1.4. SHUMAT RAPORTUESE	9
1.5. VALUTA RAPORTUESE	9
1.6. DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE	9
Neni 14.6: SHPALOSJA E NDARJEVE FILLESTARE DHE FINALE TË BUXHETIT	10
SHËNIMI 2 PAGA DHE SHITESAT	14
2.1 PAGAT E STAFIT TË AKP-SË dhe Buxheti shtesë në kategorinë e pagave për vitin fiskal 2024	14
2.2 SHPALOSJE E PAGESAVE NDAJ ANËTARËVE TË BORDIT TË AKP-SË Kodi: “Funksionarët me kohë të pjesshme” (11441)	16
SHËNIMI 3 MALLRA DHE SHËRBIME	17
3.1 SHPJEGIME LIDHUR ME PERFORMANCEN E BUXHETIT NË KATEGORINE MALLRA DHE SHËRBIME	19
3.2. SHPALOSJE PËR PAGESAT E REALIZUARA PËR SHËRBIME KONTRAKTUESE TJERA (KODI 13460)	20
SHËNIMI 4 SHPENZIME KOMUNALE	21
SHËNIMI 5 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	22
SHËNIMI 6 SHPENZIME KAPITALE	23
SHËNIMI 7 TJERA	24
SHËNIMI 8 TË HYRAT TATIMORE	25
SHËNIMI 9 TË HYRAT JO TATIMORE	25
SHËNIMI 10 TË ARDHURAT E DEDIKUARA	26
10.1. TË ARDHURAT E DEDIKUARA PËR TË MBULUAR SHPENZIMET OPERATIVE DHE ADMINISTRATIVE TË AKP-SË	26
SHËNIMI 11 GRANTET E PËRCAKTUARA TË DONATORËVE	27
SHËNIME TJERA 12	28
SHËNIME 13 PAGESA NGA PALËT E TRETA	28
SHËNIMI 16 TË ARKËTUESHMET	28
SHËNIMI 17 RAPORT PËR DETYRIMET (FATURAT) E PAPAGUARA	29
SHËNIMI 18 DETYRIMET KONTINGJENTE	30

SHËNIMI 19 RAPORT PËR PASURINË JO FINANCIARE	33
19.3.1 PASURITË KAPITALE (ME VLERË MBI 1000 EURO)	33
19.3.2 PASURITË JO KAPITALE (ME VLERË NËN 1000 EURO)	34
19.3.3 STOQET	35
SHËNIMI 20 RAPORT PËR AVANCE E PAARSYETUARA.....	35
SHËNIMI 21 RAPORT PËR TË HYRAT VETANAKE TË PASHPENZUARA	36
SHËNIMI 22 RAPORT PËR BILANCET E PASHPENZUARA TË FONDIT ZHVILLIMOR NË MIRËBESIM.....	36
SHËNIMI 23 RAPORT PËR TË ARDHURAT E DEDIKUARA.....	37
SHËNIMI 24 RAPORT PËR FONDET E DONATORËVE TË PASHPENZUARA	37
SHËNIMI 25 RAPORT PËR NUMRIN E PUNËTORËVE SIPAS LISTËS SË PAGAVE.....	38
SHËNIMI 26 RAPORT PËR NUMRIN E TË PUNËSUARVE JASHTË LISTËS SË PAGAVE	39
SHËNIMI 27 RAPORT PËR NUMRIN E TË PUNËSUARVE ME KONTRATE PËR SHËRBIME TË VEÇANTA.....	39
SHËNIMI 28 RAPORT PËR GJENDJEN/ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)	40

Neni 13: PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE**Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave në para të gatshme për Agjencinë Kosovare të Privatizimit**

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

		2024	2023	2022
		Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit
	Shënime	BKK '000	BKK '000	BKK '000
BURIMET E FONDEVE - Pranimet				
Granti Qeveritar		4,553	4,594	5,945
Të hyrat vetanake		-	-	-
Të hyrat e dedikuara		-	-	-
Të hyrat nga AKP		-	-	-
Grantet e përcaktuara të donatorëve		-	-	-
Klauzola e investimeve		-	-	-
Fondi zhvillimor në mirëbesim		-	-	-
	GJITHSEJ	4,553	4,594	5,945
SHFRYTEZIMI I FONDEVE - Pagesat				
Operacionet				
Paga dhe Shtesa	2	3,467	3,620	4,926
Mallra dhe Shërbime	3	924	879	884
Shpenzime Komunale	4	106	82	101
	GJITHSEJ	4,497	4,581	5,911
Transferet				
Transfere dhe Subvencione	5	-	-	-
Shpenzime kapitale				
Prona, ndërtesa dhe pajisje	6	56	13	34
Pagesa tjera				
	7	-	-	-
	GJITHSEJ	4,553	4,594	5,945

Neni 14: RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT**Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për Agjencinë Kosovare të Privatizimit**

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

		Janar – Dhjetor 2024				2023	2022
		Realizimi	Buxheti final	Buxheti fillestar	Ndryshimi	Realizimi	Realizimi
Shënime		A '000	B '000	C '000	D=B-A '000	E '000	F '000
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit							
Të hyrat tatimore	8	-	-	-	-	-	-
Të hyrat jo tatimore	9	-	-	-	-	-	1
*Të hyrat e dedikuara	10	-	-	-	-	-	-
Grantet e përcaktuara të donatorëve	11	-	-	-	-	-	-
Tjera	12	-	-	-	-	-	-
Gjithsej		-	-	-	-	-	1
Dalja e parasë së gatshme nga llogaria e Thesarit							
Paga dhe shtesa	2	3,467	3,467	3,091	-	3,620	4,926
Mallra dhe shërbime	3	924	1,028	1,069	104	879	884
Shpenzime komunale	4	106	150	150	44	82	101
Transfere dhe subvencione	5	-	-	5	-	-	-
Shpenzime kapitale	6	56	60	260	4	13	34
Tjerrat	7	-	-	-	-	-	-
Gjithsej		4,553	4,705	4,575	152	4,594	5,945

*AKP nuk planifikon të hyra. AKP vetëm depoziton mjetet (Të Hyrat e Dedikuara) në Buxhetin e Përgjithshëm të Kosovës për të mbuluar buxhetin e aprovuar me Ligjin e Buxhetit. AKP, nuk planifikon të hyrat si në rastin e komunave, por për çështje të raportimit, nga Departamenti i Thesarit, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve është kërkuar që të raportohet në këtë mënyrë. Detajet janë të shpalosura në shënimin nr. 10 dhe nr. 23.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2024 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

1.1. POLITIKAT KONTABËL

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik si dhe rregullores të Ministrisë së Financave të vitit 2017 “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”. Rregullorja i përmbush të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063, Ligjin nr. 05/L-007 dhe Ligjin 08/L-183 për mbështetjen e punëve publike.

1.2. INFORMATA PËR ORGANIZATËN BUXHETORE

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka përgatitur Pasqyrat Financiare në harmoni me kërkesat e Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

Sipas LMFPF të gjitha transaksionet me fonde brenda Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës bëhen përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit, MFPT.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është një organ i pavarur publik i cili ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur, në bazë Ligjit Nr. 04/L-034, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05-/L-080, ligjin Nr. 04/L-115 për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës si dhe ndryshim plotësimin me ligjin Nr. 06/L-023.

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve takohet në baza të rregullta mujore në mënyrë që t'i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas Ligjit. Bordi i Drejtorëve emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendor sipas nenit 8 të ligjit nr. 06/L -023.

Agjencia Kosovare e Privatizimit në baza vjetore i raporton Kuvendit të Republikës të Kosovës sipas formatit të raportimit për Agjencitë e Pavarura. Raporti vjetor paraqet të gjitha detajet e aktiviteteve dhe informatave financiare dhe jo financiare për vitin fiskal 2024.

Aktiviteti kryesor i AKP-së është privatizimi dhe likuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSh-ve). Aktivitet tjetër i AKP-së është administrimi, ristrukturimi dhe riorganizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore aty ku paraqitet nevoja deri në përmbylljen e procesit të likuidimit. Agjencia Kosovare e Privatizimit administron Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë dhe i mban këto Ndërmarrje në mirëbesim. Si administruese e besuar, AKP është e ngarkuar me "ruajtjen dhe rritjen" e vlerës të NSh-ve.

Më 30 shtator 2024, Bordi i Drejtorëve të AKP-së, ka pranuar dorëheqjen z. Arben Limani, Drejtor Ekzekutiv, me efekt nga data 21 nëntor 2024. Nga data 22 nëntor 2024, në këtë është emëruar z. Ibrahim Gjylderan si U.D. Drejtorit Ekzekutiv.

Gjatë vitit 2024, janë emëruar dy Zëvendës Drejtorë Ekzekutivë të AKP-së në përputhje me Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe procedurat e rekrutimit. Të emëruarit janë Z. Burim Leci, Zëvendës Drejtor Ekzekutiv – Operativ më 15 korrik 2024 dhe z. Ibrahim Gjylderan, Zëvendës Drejtor Ekzekutiv – Funksione

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2024
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

të Përgjithshme nga data 1 shtator 2024. Gjatë periudhës paraprake të raportimit, këto pozita janë ushtruar nga dy ushtruesit e detyrës, z. Petrit Ibraj dhe z. Muharrem Arifi.

Pasqyrat Financiare paraqesin subjektin raportues ashtu siç është specifikuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Periudha raportuese e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në këto pasqyra financiare është prej **1 janar deri më 31 dhjetor 2024**. Buxheti i AKP-së gjatë periudhës raportuese është financuar nga **Granti Qeveritar (GQ)**.

Të hyrat e Dedikuara (THD) - Sipas nenit 15 të Ligjit nr. 06/L -023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, **janë: Të gjitha të ardhurat e Agjencisë do të jenë të ardhura të dedikuara të Agjencisë sipas nenit 64 të LMFP-së. Përveç kësaj, pesë përqind (5%) e të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga Agjencia apo paraardhësja e saj, do të jetë tarifë administrative e Agjencisë për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative; dhe ajo tarifë do të jetë pjesë e të ardhurave të dedikuara të Agjencisë. Agjencia në baza vjetore i transferon dhe depoziton të gjitha ato të ardhura nga tarifa në Fondin e Konsoliduar të Kosovës, në pajtim me rregullat në fuqi të LMFP-së. Thesari dhe Ministria e Financave sigurojnë që ato fonde të vendosen dhe mbahen në llogarinë e dedikuar të ardhurave të Agjencisë.**

Granti Qeveritar (GQ) është fondi i cili financon të gjitha aktivitetet e organizatave buxhetore. Në rastin e Agjencisë, nga Granti Qeveritar janë financuar të gjitha aktivitetet administrative dhe operative për vitin fiskal 2024.

1.3. PAGESAT NGA PALËT E TRETA

Në zbatim të SNKSP pagesat nga palët e treta shpalosen në shënimin 13.

1.4. SHUMAT RAPORTUESE

Shumat raportuese nga formati i pasqyrave financiare nga neni 13 deri te neni 15 janë në `000 (mijë) Euro (€) dhe nga neni 16 deri te neni 24 shumat janë të plota Euro (€).

1.5. VALUTA RAPORTUESE

Shumat janë raportuar në valutën Euro (€).

1.6. DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare autorizohen në datën e nënshkrimit të deklaratës së Pasqyrave Financiare nga Z. Ibrahim Gjyliden U.D. Drejtor Ekzekutiv (Zyrtari Kryesore Administrativ) dhe Z. Adem Selishta - Drejtor i Financave dhe Buxhetit (Zyrtari Kryesore Financiar).

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2024
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 14.6: SHPALOSJA E NDARJEVE FILLESTARE DHE FINALE TË BUXHETIT

Kategoria e ndarjes	Ndryshimet e autorizuara nga LMFP					Grand et e donat orëve	Burime tjera të financimit	Buxheti përfundimtar SIMFK
	Buxheti Fillestar (Ligji Nr. 08/L-260)	Ndryshimi buxhetor vendimi i Qeverisë nr. 22/233	Ndryshimi buxhetor vendimi i Qeverisë nr. 14/238	Ndryshimi buxhetor vendimi i Qeverisë nr. 03/239	Të hyrat vetanake			
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Hyrjet								
Të hyrat tatimore	-	-	-	-	-	-	-	-
Të hyrat jo tatimore	-	-	-	-	-	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	-	-	-	-	-	-	-	-
Grandet e përcaktuara të donatorëve	-	-	-	-	-	-	-	-
Huamarrjet	-	-	-	-	-	-	-	-
Tjera	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	-	-	-	-	-	-	-	-
Daljet								
Paga dhe shtesat	3,091	104	-	272	-	-	-	3,467
Mallra dhe shërbime	1,069	-	(41)	-	-	-	-	1,028
Shpenzime komunale	150	-	-	-	-	-	-	150
Transfere dhe subvencione	5	-	(5)	-	-	-	-	0
Shpenzime kapitale	260	-	(200)	-	-	-	-	60
Kthimi i huamarrjeve	-	-	-	-	-	-	-	-
Tjerrat	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	4,575	104	(246)	272	-	-	-	4,705

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2024
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Më poshtë do paraqesim një shpalosje lidhur me shkurtime buxhetore dhe kërkesat shtesë nga AKP-ja dhe vendimet e qeverisë përkatësisht vendimi nr. **22/233, 14/238 dhe 03/239** lidhur me kërkesat e parashtruara nga AKP-ja.

Vlera që AKP ka deklaruar për kursime pran MFPT është shuma prej EUR 246,500, nga kjo vlerë janë marrë si kursime vlera prej EUR 200,000 nga kategoria ekonomike e investimeve kapitale, EUR 5,000 nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe EUR 41,500 nga kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve. Lëvizjet tjera në buxhet janë si më poshtë:

Mallra dhe Shërbime:

Me kërkesën e AKP-së, janë bërë kursime buxhetore në Kategorinë e Mallrave dhe në vlerën EUR 41,500. Kursimet janë bërë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Paga dhe Shtesat:

Sipas Ligjit të Buxhetit për vitin fiskal 2024, numri i nëpunësve të AKP-së (234) dhe Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve (8) është i aprovuar në total 242.

Në kategorinë paga dhe mëditje buxheti fillestar ka qenë EUR 3,091,304.00 ndërsa ai përfundimtar është EUR 3,466,804.22. Këtu përfshihen pagat bruto dhe kontributet për nëpunësit e AKP-së si dhe kompensimi i 8 anëtarëve të bordit të AKP-së.

Gjithsej shpenzimi i buxhetit në kategorinë e pagave është EUR 3,466,480.97. Realizimi i buxhetit në këtë kategori është 99.99%. Në detaje janë shpalosur te shënimi 2.1 Pagat e Stafit të AKP-së dhe 2.2.

Pagat dhe mëditjet e zyrtarëve të AKP-së sipas listës së pagave procedohen përmes Divizionit të Pagave në kuadër të Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. AKP dërgon listat e punëtorëve (stafit të saj) për periudhat përkatëse në këtë divizion dhe nga i cili procedohen pagesat në llogaritë përkatëse të punëtorëve të AKP-së. Pagesat për kontributin e punëdhënësit dhe tatimin në burim realizohen direkt në Administratës Tatimore të Kosovës.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2024
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Shpenzimet Kapitale:

Për periudhën raportuese, buxheti i aprovuar fillestar për shpenzime kapitale ka qenë EUR 260,000 ndërsa buxheti final është EUR 60,000, dhe është financuar nga Granti Qeveritar (GQ).

Mjetet kanë qenë të destinuara për tri projekte kapitale:

1. Blerja e pajisjeve të TI-së për ngritjen e cilësisë të shërbimeve, vlera EUR 20,000.00.

Projekti është realizuar dhe teprica e shumës së pa shpenzuar është EUR 702.00.

2. Blerja dhe instalimi i barrierave optike me krah vlera EUR 40,000.00.

Projekti është realizuar dhe teprica e shumës së pa shpenzuar është EUR 3,110.00.

3. Data baza e arkivës së AKP-së (kodi i projektit 19256), vlera EUR 200,000.00.

AKP-ja ka deklaruar kursim pranë MFPT, gjatë përmbylljes së vitit fiskal, në muajin nëntor 2024 shumën prej EUR 200,000 (paraqitet në tabelën e ndryshimeve buxhetore) në sistemin e Freebalancit. Këto mjete janë zbritur nga buxheti i kategorisë së shpenzimeve Kapitale dhe si i tillë është reduktuar edhe në Buxhetin e Agjencisë.

Projekti Data baza e arkivës së AKP-së (kodi i projektit 19256) nuk ka mundur të realizohet në vitin 2024 dhe si i tillë është paraqitur si kursim dhe njëkohësisht është kërkuar të bartet për vitin 2025. Sipas vendimit të Qeverisë nr. 14/238 mjetet për këtë projekt janë zbritur nga buxheti i AKP-së për vitin 2024 dhe ato janë bartur/aprovuar për projektin e njëjtë në Ligjin e buxhetit për vitin 2025 (*shih shënim 6 më i detajuar*).

Vlera e kursimeve nga vendimet e Qeverisë për AKP-në për vitin fiskal 2024 sipas kategorive ekonomike është paraqitur në formë tabelare si më poshtë:

- **Ndryshimi buxhetore I - sipas vendimit të Qeverisë me nr. 22/233 të datës 27/11/2024**

		1	2	3	4	5	6	7=Σ(1:6)
Nr.	Përshkrimi	Administrata Qendrore	Auditimit	Departamenti Ligjor	Riorganizimi dhe administrimi i NSH	Privatizimi	Likuidimi	Totali
1	Paga dhe shtesa	104	-	-	-	-	-	104
2	Mallra dhe shërbime	-	-	-	-	-	-	-
3	Shpenzime komunale	-	-	-	-	-	-	-

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2024
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

5	Transfere dhe subvencione	-	-	-	-	-	-	-
6	Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej		104	-	-	-	-	-	104

- **Ndryshimi buxhetore II - sipas vendimit të Qeverisë me nr. 14/238 datës 18 dhjetor 2024**

		1	2	3	4	5	6	7=Σ(1:6)
Nr.	Përshkrimi	Adminsitrata Qendrore	Auditimit	Departamenti Ligjor	Riorganizimi dhe administrimi i NSh	Privatizimi	Likuidimi	Totali
1	Paga dhe shtesa	-	-	-	-	-	-	-
2	Mallra dhe shërbime	-	(5)	(4)	(2)	(30)	-	(41)
3	Shpenzime komunale	-	-	-	-	-	-	-
5	Transfere dhe subvencione	-	-	-	(5)	-	-	(5)
6	Shpenzime kapitale	-	-	-	-	(200)	-	(200)
Gjithsej		-	5	4	7	230	5	246

- **Ndryshimi buxhetore II - sipas vendimit të Qeverisë me nr. 03/239 të datës 24 dhjetor 2024**

		1	2	3	4	5	6	7=Σ(1:6)
Nr.	Përshkrimi	Adminsitrata Qendrore	Auditimit	Departamenti Ligjor	Riorganizimi dhe administrimi i NSh	Privatizimi	Likuidimi	Totali
1	Paga dhe rroga	272	-	-	-	-	-	272
2	Mallra dhe shërbime	-	-	-	-	-	-	-

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2024
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

3	Shpenzime komunale	-	-	-	-	-	-
5	Transfere dhe subvencione	-	-	-	-	-	-
6	Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-
Gjithsej		272	-	-	-	-	272

SHËNIMI 2 PAGA DHE SHTESAT

	2024				2023	2022
	Gjithsej Pagesat	GQ	THD	Buxheti Final	Ndryshimi Buxheti - Pagesat	
Përshkrimi	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Pagat neto përmes listës së pagave	1,420	1,420	-	1,420	-	2,832
Shtesat Tranzitore	1,190	1,190	-	1,190	-	-
Përvoja e punës për stafin e AKPs	94	94	-	94	-	-
Funksionar me kohë të pjesshme	219	219	-	219	-	214
Tatimi i ndaluar në të ardhura personale	231	231	-	231	-	249
Kontributi pensional-punëtori	155	155	-	155	-	162
Kontributi pensional-punëdhënësi	155	155	-	155	-	162
Shtesa për kushte të tregut të punës	3	3	-	3	-	-
PAGA DHE RROGA -	3,467	3,467	-	3,467	-	3,620

2.1 PAGAT E STAFIT TË AKP-SË dhe Buxheti shtesë në kategorinë e pagave për vitin fiskal 2024

Numri i punëtorëve dhe Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve i aprovuar sipas Ligjit të buxhetit për vitin 2024 është 242 (234 nëpunës dhe 8 Anëtarët e Bordit të Drejtorëve). Detajet janë paraqitur në shënimin shpjegues nr. 25.

Po ashtu në numrin e përgjithshëm të punëtorëve të buxhetuar janë të përfshirë edhe 8 Anëtarët e Bordit të Drejtorëve. Detajet janë paraqitur në shënimin shpjegues nr. 2.2.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2024
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Pagat dhe mëditjet procedohen përmes Divizionit të Pagave në kuadër të Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. AKP dërgon listat e punëtorëve (stafit të saj) për periudhat përkatëse në këtë Divizion dhe nga i cili procedohen pagesat në llogaritë përkatëse të punëtorëve të AKP-së. Pagesat për kontributin e punëdhënësit dhe tatimin në burim realizohen direkt në Administratën Tatimore të Kosovës.

Shpenzimet për paga dhe mëditje përfshijnë pagat bruto dhe kontributet për nëpunësit e AKP-së si dhe kompensimin e 8 anëtarëve të bordit të AKP-së. Në kategorinë paga dhe mëditje buxheti fillestar ka qenë EUR 3,091,304 ndërsa ai përfundimtar është EUR 3,466,804.22. Buxheti për paga është rritur për EUR 375,500, për arsyt e shpjeguara në vijim:

Bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr. AGJ 2316/24, përkitazi me çështjen e pagave, pagat e AKP-kanë vazhduar të realizohen pa zbritjen e shtesës tranzitore prej 50%. Rrjedhimisht, MFPT, përmes vendimit të Qeverisë nr. 22/233 dhe 03/239, ka alokuar buxhet shtesë prej EUR 375,500 për të mundësuar realizimin e pagave të stafit të AKP-së deri në fund të vitit 2024.

Gjithsej shpenzimi i buxhetit në kategorinë e pagave është EUR 3,466,480.97. Realizimi i buxhetit në këtë kategori është 99.99%. Shpenzimet për Pagat Bruto dhe kontributet për nëpunësit e AKP-së për vitin 2024 janë gjithsej EUR 3,247,459.97. Buxheti i shpenzuar për kompensimin e Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, Komitetit të Auditimit dhe Komisionit për vlerësim të performancës së Menaxhmentit për vitin 2024 është në vlerën EUR 217,550. Ndërsa, EUR 1,471 janë shpenzime e angazhimit të ekspertëve të jashtëm të angazhuar në hapje të ofertave për valët e privatizimit dhe ekspertëve e angazhuar si anëtar të komisionit sipas Ligjit për rekrutimin e pozitive të larta. Kompensimi dhe Kontributet e pagesave të Bordit janë realizuar nga kodi ekonomik "Funksionarët me kohë të pjesshme" (11441).

LËVIZJET E STAFIT:

- **REKRUTIMET:** Gjatë kësaj periudhe, Divizioni i Burimeve Njerëzore (DBNJ) ka udhëhequr me gjashtë (8) procedura të rekrutimit, prej tyre pesë (5) kanë dështuar. (Një) 1 proces i filluar në vitin 2023 ka përfunduar gjatë vitit 2024.
- **DORËHEQJE:** Për arsye personale gjashtë (7) punonjës kanë dhënë dorëheqje.
- **TRANSFERET E PËRHERSHME:** Tetë (8) punonjës janë transferuar në mënyrë të përhershme.
- **TRANSFERET E PËRKOSSHME:** Shtatëmbëdhjetë (17) punonjës janë transferuar në mënyrë të përkohshme, prej tyre (pesë) 5 janë caktuar në vitin 2023 me afat deri në vitin 2024
- **PEZULLIM I DAKORDUAR:** Tetë (8) punonjësve u është lejuar pezullimi i dakorduar i marrëdhënies së punës sipas Ligjit në fuqi.
- **PUSHIM LEHONIE:** (pesë) 5 zyrtarë kanë shfrytëzuar pushimin e lehonisë, prej të cilave (një) 1 punonjëse pushimin e lehonisë e ka filluar në vitin 2023.
- **PENSIONIME:** Pesë (5) nëpunës janë pensionuar.
- **ZËVENDËSIMET:** Gjatë vitit 2024, (pesëmbëdhjetë) 15 pozita janë zëvendësuar nga zyrtar të caktuar në periudha të ndryshme. (Gjashtë) 6 prej tyre janë caktuar në vitin 2023 me afat deri në vitin 2024.

**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2024
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

Si rrjedhojë e procesit të ristrukturimit të strukturës organizative e AKP-së e cila ka hyrë në fuqi nga data 1 tetor 2023, janë shuar 5 departamente dhe 7 njësi (divizione). Numri i zyrtarëve që ju është shuar pozita është (shtatë) 7. Prej tyre, (tre) 3 zyrtar janë sistemuar në pozita ekuivalente brenda AKP-së, ndërsa në mungesë të pozitave të lira, (katër) 4 zyrtar janë ende në listë të pritjes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil (KPMSHC), me vendimin nr. A 1406/2023, ka konstatuar se procesi i ristrukturimit në AKP ka filluar sipas nenit 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për ZP, sipas të cilit AKP obligohet ti transferojë shërbyesit civil në pozitë tjetër të sh. civil të së njëjtës kategori. Ndërsa, pozita të së njëjtës kategori nuk ka.

KPMSHC, gjithashtu, me vendimin nr. A.nr.556/2023 i, konstaton se “nëpunësit civil sistemohen në vendet e reja të krijuara, të ristrukturuar apo të mbetura si pasojë e ristrukturimit apo shuarjes së institucionit, në të njëjtën kategori.

Lidhur me çështjen në fjalë, Agjencia ka bërë përpjekje të zgjidhë këtë çështje përmes Departamentit për Menaxhim të Zyrtarëve Publik (DMZP) të Ministrisë së Punëve të Brendshme duke kërkuar nga DMZP të bëjë sistemin e 4 zyrtarëve të listës në pritje në institucione tjera shtetërore.

DMZP ka refuzuar kërkesën me arsyetimin se nuk është përgjegjëse për sistemin e zyrtarëve të institucioneve të pavarura siç është AKP. Sidoqoftë, lidhur me sistemin e nëpunësve civil, neni 67 paragrafi 2 i Ligjit nr. 08/L-197 për Zyratet Publik, përcakton se:

“Ministria përgjegjëse për administratë publike, kujdeset për sistemin e nëpunësve civil në pritje në kategori të njëjtë të shërbimit civil, si dhe trajnimin për pozitën përkatëse ku sistemohet”.

2.2 SHPALOSJE E PAGESAVE NDAJ ANËTARËVE TË BORDIT TË AKP-SË Kodi: “Funkionarët me kohë të pjesshme” (11441)

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendorë të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe kompensohet sipas Rregullores për Kompensimin e Drejtorëve të Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Me datën 2 gusht 2024 znj. V.K. ka dhënë dorëheqje nga pozita e Drejtorit në Bordin e Agjencisë Kosovare te Privatizimit.

Për periudhën raportuese, pagesat në vlerën prej EUR 217,550 të realizuara ndaj Anëtarëve të Bordit të AKP-së dhe raste tjera prej EUR 1,471 për ekspertet e jashtëm të angazhuar në komisione për rekrutim të kandidatëve, pasqyrohen si më poshtë:

		1	2	3	4=1+2+3
Nr.	Përshkrimi	Pagesat neto	Tatimet	Kontributet pensionale (5+5%)	Gjithsej
1	Për mbledhje të Bordit	167,614	19,352	18,503	205,469
2	Për komisionet e Bordit	9,293	1,846	942	12,081
3.	Për ekspertët e jashtëm	1,198	133	140	1,471
Gjithsej		178,105	21,331	19,585	219,021

**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2024
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

Pagesat e realizuara gjatë periudhës raportuese kanë të bëjnë me aktivitetet e mëposhtme:

- Bordi i Drejtorëve të AKP-së i ka mbajtur 22 mbledhje gjatë vitit 2024;
- Komiteti i auditimit ka mbajtur 6 takime dhe ka pas angazhime gjatë tërë vitit fiskal.
- Komisioni i vlerësimit të performancës së Menaxhmentit ka mbajtur 15 takime

Buxheti i shpenzuar për kompensimin e Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, Komitetit të Auditimit dhe Komisionit për vlerësim të performancës së Menaxhmentit për vitin 2024 është në vlerën EUR 217,550. Shpenzime e angazhimit të ekspertëve të jashtëm të angazhuar në hapje të ofertave për valët e privatizimit dhe ekspertëve e angazhuar si anëtar të komisionit sipas Ligjit për rekrutimin e pozitave të larta në vlerën EUR 1,471 në total shpenzimet janë EUR 219,021.00.

SHËNIMI 3 MALLRA DHE SHËRBIME

Shumat e paraqitura në tabelën e mallrave dhe shërbimeve janë financuar nga Granti Qeveritar (GQ). Më poshtë janë paraqitur dhe shpalosur në detaje shënimet lidhur me natyrën e shpenzimeve.

Përshkrimi	2024				Ndryshimi Buxheti - Pagesat € '000	2023	2022
	Gjithsej Pagesat	GQ	THD	Buxheti Final			
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000		€ '000	€ '000
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit	-	-	-	-	-	-	-
Mëditja e udhëtimit zyrtar brenda vendit	-	-	-	-	-	-	-
Akomodimi për udhëtimit zyrtar jashtë vendit	-	-	-	2	2	-	-
Shpenzimet tjera për udhëtime zyrtare brenda vendit	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet e tjera e udhëtimit zyrtare jashtë vendit	1	1	-	2	-	-	-
Shpenzimet për internet	4	4	-	4	-	6	16
Shpenzimet e telefonisë mobile	20	20	-	20	-	17	17
Shpenzimet postare	2	2	-	2	-	1	1
Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	9	9	-	9	-	6	-
Sigurimi fizik i objekteve publike	267	267	-	267	-	-	-
Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse	-	-	-	-	-	2	2
Shërbime shtypje - jo marketing	3	3	-	3	-	-	-

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2024
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Shërbime Kontraktuese Tjera	52	52	-	59	7	319	274
Shërbime Teknike	-	-	-	10	10	-	-
Mobile (me pak se 1000 euro)	1	1	-	6	5	5	3
Kompjuterë (me pak se 1000 euro)	28	28	-	28	-	-	-
Harduer për teknologji informative (me pak se 1000 euro)	5	5	-	5	-	6	21
Pajisje tjera (me pak se 1000 euro)	1	1	-	1	-	14	-
Furnizime për zyrë	8	8	-	8	-	33	20
Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	8	8	-	7	-	9	10
Furnizime pastrimi	7	7	-	7	-	11	10
Furnizim me veshmbathje	-	-	-	-	-	-	-
Naftë për ngrohje qendrore	4	4	-	5	1	14	24
Derivate për gjenerator	4	4	-	5	1	1	4
Karburant për vetura	24	24	-	30	6	22	24
Vaj	-	-	-	-	-	-	-
*Avance	-	-	-	1	1	1	-
Regjistrimi i automjeteve	2	2	-	3	1	2	2
Sigurimi i automjeteve	8	8	-	9	1	8	9
Taksa komunale e regjistrimit të automjeteve	-	-	-	-	-	-	-
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	19	19	-	25	6	26	25
Mirëmbajtja e ndërtesave	1	1	-	1	-	1	2
Mirëmbajtja e ndërtesave administrative afariste	1	1	-	1	-	22	19
Mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve	34	34	-	37	3	16	10
Qiraja për ndërtesa	92	92	-	117	25	104	119
Qiraja për pajisje	1	1	-	2	-	-	-
Qiraja për përdorime tjera hapësinore	178	178	-	189	11	188	189
Softuerët licencat dhe mirëmbajtja e tyre	22	22	-	22	1	-	-
Qiraja për automjete	22	22	-	22	-	-	-
Botimet e publikimeve	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet për informim publik	63	63	-	84	21	39	79

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2024
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Drekat zyrtare	8	8	-	10	2	6	4
Shpenzime-vendimet e gjykatave	25	25	-	25	-	-	-
MALLRA DHE SHËRBIME	924	924	-	1,028	104	879	884

- *Avanci buxhetor për paratë e imëta që është mbajtur në arkë.* Të gjitha pagesat e bëra në vlerën prej **EUR 500.00**, gjatë vitit fiskal 2024, janë kategorizuar sipas planit kontabël, gjendja në fund të vitit, ashtu siç kërkohet me procedura është mbyllur dhe është zero.
- *Avanci për udhëtimin zyrtarë jashtë vendit është dhënë në vlerën prej EUR 1,388, gjatë vitit fiskal 2024 është mbyllur me kohe dhe ne mënyrë te rregullt me shpenzimet kontabël me vlerat EUR 729.10 kodi ekonomik 13143, EUR 474.90 kodi ekonomik 13142, EUR 184.00 kodi ekonomik 13141. Një prej vlerave është paraqitur në tabelën me lartë, përveç vlerave më të ulëta EUR 474.90 dhe EUR 184.00 të cilat po i shpalosim këtu.*
- Konform nenit 40 të LMFPP-së dhe legjislacionit tjetër në fuqi, Thesari është i obliguar të ekzekutojë vendimet gjyqësore/përmbartimore të formës së prerë.

Ish-Bordi i Drejtorëve ka mbajtur mbledhje më datën 27 maj 2021. Sekretaria e Bordit të Drejtorëve ka konfirmuar prezencën e tyre konform Procedurës për Kompensim të BD dhe ka përcjell kërkesën për procedim të pagesës në Departamentin për Buxhet dhe Financa (DFB). Mirëpo Kuvendi i Kosovës po atë ditë më 27 maj 2021 ka shkarkuar Anëtarët e Bordit të Drejtorëve. Departamenti i Thesarit, MFTP, nuk ka alokuar mjetet për procedim të pagesës në vlerë EUR 25,265.

Ndërsa, në fund të muajit gusht 2024 Thesari ka ekzekutuar këtë pagesë në vlerë EUR 25,265, sipas vendimit përmbartimor nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, edhe pse AKP ka rekomanduar që ekzekutimi i këtij vendimi të bëhet nga kategoria e pagave dhe shtesave.

3.1 SHPJEGIME LIDHUR ME PERFORMANCEN E BUXHETIT NË KATEGORINE MALLRA DHE SHËRBIME

Në kategorinë mallra dhe shërbime buxheti i aprovuar fillestar nga Granti Qeveritar (GQ) në kategorinë mallra dhe shërbime është EUR 1,069,382.00 ndërsa ai përfundimtar EUR 1,027,882.00.

Diferenca prej EUR 41,500 është rezultat kursimeve buxhetore të cilat AKP i ka paraqitur pranë MFPT-së me datën 19 nëntor 2024. Realizimi përfundimtar i buxhetit në këtë kategori është gjithsej 89.90%

Fondet e aprovuara në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime kanë qenë të destinuara:

- Për të mbuluar shpenzimet operative dhe administrative;
- Për të mbuluar shpenzimet e procesit të Privatizimit dhe Likuidimit;
- Për të mbështetur në aspektin ligjor procesin e privatizimit dhe likuidimit;

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2024
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Në tremujorin e fundit të vitit 2024, në kategorinë mallra dhe shërbime kemi identifikuar kursime buxhetore në vlerë prej EUR 41,500 të cilat, gjatë përmbylljes së vitit fiskal, i kemi paraqitur pranë MFPT-së dhe njëkohësisht kemi kërkuar që mjetet e kursyera të reduktohen nga buxheti i Agjencisë.

Rrjedhimisht, MFPT ka aprovuar kursimet dhe ka zbritur buxhetin sipas vendimit të Qeverisë nr. 14/238. Gjithsej mbetja e buxhetit të pashpenzuar (pas kurimeve) për vitin 2024 është EUR 103,834.91.

Në renditjen e mëposhtme janë shpalosur disa nga linjat më relevante në të cilat ka pasur shpenzim më të ulët se sa planifikimi fillestar:

- Derivate dhe lëndë djegëse (naftë për ngrohje qendrore, derivate për qjenerator, karburant dhe vaj për vetura;
- Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve;
- Blerje e mobilie dhe pajisjeve (më pak se 1000 euro);
- Mirëmbajtja e ndërtesave, mobileve dhe pajisjeve;
- Shpenzimet për informim publik; dhe
- Arkivimi i dokumenteve të Ndërmarrjeve Shoqërore (në pesë Zyrat Rajonale) pas privatizimit dhe derisa të përfundojë likuidimi;

Shumat e teprcës së buxhetit të pa shpenzuar janë të shpalosura te pasqyrat financiare të programeve përkatëse buxhetore.

3.2. SHPALOSJE PËR PAGESAT E REALIZUARA PËR SHËRBIME KONTRAKTUESE TJERA (KODI 13460)

Sa i përket pagesave, në mënyrë që lexuesi të ketë një pasqyrë më të qartë, do të pasqyrohen më në detaje në tabelat e mëposhtme, pasi që brenda një kategorie (kudit ekonomik të shpenzimeve) janë realizuar pagesa për shërbime të ndryshme dhe që kanë vlera të mëdha.

Shërbimet kontraktuese tjera në shumën prej EUR 52,090 përfshinë pagesat si më poshtë:	VLERA	% e totalit
Pagesat ndaj BSPK-së si kompensim për shpenzimet mujore lidhur me 20% e punëtorëve	40,424	77.60%
Pagesat për ndejën e fund vitit me stafin e AKP-së	7,500	14.40%
Shpenzime tjera kontraktuale	4,166	8.00%
GJITHSEJ PAGESA TE REALIZUARA NË KATEGORINË “SHËRBIME KONTRAKTUESE TJERA”	52,090	100.00%

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2024
